

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXII, nr. 6728  
E martë, 11 tetor 2022  
çmimi 0.40

Në Ushtrinë e Kosovës  
mbi 11 për qind janë gra

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

ISH LIDERI STUDENTOR I '97-'99, MUHAMET MAVRAJ, FLET PËR VIZITËN NË HAGË  
NË EMISIONIN "FRONTAL" TË TELEVISIONIT T7

## MAVRAJ: ATA NË HAGË JANË TOP FARE, NDËRSA GJYKATA SPECIALE ËSHTË PARTI SPECIALE

FRONTAL, Muhamet Mavraj - 03.10.2022



LIVE

Mavraj:  
Dy binarët e  
politikës  
anti-UÇK të  
nisur në 2010  
u takuan në  
vitin 2019

Në studio: Muhamet Mavraj, publicist

**TAKIMI ME ISH-KRERËT E UÇK-SË, ÇFARË PO BËN SHTETI NË MBROJTJE TË TYRE?**

### PDK-ja THEMELON KËSHILLIN POLITIK, DREJTOHET NGA ARSIM BAJRAMI



Në 23-vjetorin e themelimit të partisë, kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, me vendim të kryesisë, ka themeluar të hënën Këshillin Politik, një organ këshillëdhënës i partisë. Këshilli Politik ka 31 anëtarë, ndërsa përbëhet nga koordinatori dhe 30 anëtarë të partisë



**EMËROHET KOMANDANTI I RI I  
KFOR-it NË KOSOVË, ZOTOHET  
PËR BASHKËPUNIM**

FAQE 7

**KOMISIONI EVROPIAN PËRSËRIT SE VIZAT PËR QYTETARËT E KOSOVËS DUHET TË HIQEN**

FAQE 4

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
+389 44 487 200  
+377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË



**MILANI PËR HAKMARRJE NDAJ  
CHELSEAT**

F. 10

**Kolegji BIZNESI**  
  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



# NATO-ja dhe BE-ja dënojnë ashpër valën “e tmerrshme” të sulmeve të Ruisë në Ukrainë

**BRUKSEL, 10 TETOR** - Shefi i NATO-s, Jens Stoltenberg, dhe aleatët evropianë, kanë kritikuar valën “e tmerrshme” të sulmeve ajrore të Ruisë në Ukrainë të cilat kanë lënë të vdekur shtatë civilë dhe kanë plagosur mbi 60 të tjerë më 10 tetor.

Moska, në anën tjetër, i ka konsideruar sulmet si hakmarrje për veprimet “terroriste” të Kievit, duke përfshirë aty edhe sulmin në fundjavë, në urën e vetme që lidh Ruisë me Gadishullin e aneksuar të Krimesë.

Kievi dhe disa qytete të tjera ukrainase janë shënjestruar në orët e para të 10 tetorit nga disa valë të sulmeve me raketa.

Autoritetet ukrainase kanë thënë se rajonet Lviv, Poltava, Sumi dhe Ternopil kanë mbetur pa rrymë pas sulmeve dhe se me probleme të ngjashme mund të përballen edhe qytezat e tjera.

Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky ka thënë se Rusia i ka planifikuar me qëllim sulmet në mëngjesin e 10 tetorit për të shkakuar sa më shumë viktima civile dhe se ka sulmuar infrastrukturën shtetërore për energji përmes dronëve të prodhuar nga Irani.

Presidenti rus Vladimir Putin ka thënë më 10 tetor se sulmet kanë qenë shenjë e hakmarrjes ndaj veprimeve të Kievit. Sipas tij, ushtria ruse ka përdorur më 10 tetor “armë precize” nga ajri, deti



dhe toka, për t'i shënjestruar objektet kyçe të energjisë dhe ushtrisë.

Mirëpo si pasojë e sulmeve në Kiev, dhe qytetet e tjera të mëdha ukrainase, janë goditur ndërtesa banimi dhe objekte të rëndësishme infrastrukturore. “Kam folur me ministrin e Jashtëm ukrainas, Dmytro

Kuleba, dhe i kam dënuar sulmet e tmerrshme në infrastrukturën civile të Ukrainës. NATO-ja do të vazhdojë ta mbështesë popullin e guximshëm ukrainas për të luftuar kundër agresionit të Kremlinit, aq sa të ketë nevojë”, ka thënë Stoltenbergu.

Presidentja e Komisionit

Evropian, Ursula von der Leyen, ka thënë se është “e shokuar” nga sulmet e Ruisë. “Rusia ia ka dëshmuar edhe një herë botës se çfarë përfaqëson: terror dhe brutalitet”, ka thënë von der Leyen.

Lufta në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt.

Presidenti rus Vladimir Putin e

quan luftën si “operacion special ushtarak” për ta çmilitarizuar Ukrainën.

Perëndimi është përgjigjur ndaj Ruisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

## Gjermania do të dërgojë në Ukrainë sisteme të mbrojtjes ajrore



**BERLIN, 10 TETOR** - Gjermania tha se do të dërgojë në Ukrainë katër sistemet e para të mbrojtjes ajrore të llojit IRIS-T SLM. Këto sisteme do të arrijnë në Ukrainë “brenda ditësh”.

Ky njoftim i Berlinit erdhi në ditën kur Rusia sulmoi disa qytete ukrainase, duke vrarë civilë. “Sulmet e reja me raketa në Kiev dhe në qytete të tjera të mëdha, e kanë bërë të qartë se sa e

rëndësishme është që në Ukrainë të dërgohen shpejt sisteme të mbrojtjes ajrore”, tha ministrja gjermane e Mbrojtjes, Christine Lambrecht, përmes një deklarate më 10 tetor.

Ky njoftim erdhi disa orë pas sulmeve në Ukrainë. “Sulmet me raketa dhe dronë rusë fillimisht terrorizojnë popullatën civile. Prandaj, ne po i mbështesim ata me armë kundërajrore”, shtoi ajo.

Presidenti rus Vladimir Putin tha se sulmet janë në kundërpërgjigje të veprimeve të Kievit, që ai i cilësoi “terroriste”, përfshirë edhe sulmin gjatë fundjavës në urën kyçe që lidh Ruisë me Gadishullin e aneksuar të Krimesë.

Policia kombëtare ukrainase tha se të paktën dhjetë persona janë vrarë dhe 60 janë plagosur nga sulmet ajrore.

## Tre amerikanë fitojnë Nobelin për ekonomi

**STOKHOLM, 10 TETOR** - Një grup prej tre ekonomistësh amerikanë, përfshirë ish-shefin e Rezervës Federale të ShBA-së, Ben Bernanke, ka fituar Çmimin Nobel për Ekonomi për shkak të hulumtimit lidhur me krizat bankare dhe financiare.

Akademia Mbretërore Suedeze e Shkencës, tha se Bernanke, Douglas Diamond dhe Philip Dybvig kanë fituar Nobelin për hulumtimin e


tyre që “ndjeshëm përmirësoi kuptimin e rolit të bankave në ekonomi, veçanërisht gjatë krizave financiare”. “Gjetjet e laureatëve kanë përmirësuar aftësinë tonë për t'i shmangur edhe krizat serioze dhe pakot e shtrenjta të shpërthimit”, tha Tore Ellingsen, kryetar i Komitetit për Çmimin për Shkenca Ekonomike.

Bernanke aktualisht punon në Institutin Bruking në Uashington, Diamond është

profesor në Universitetin e Çikagos, ndërkaq Dybvig është profesor në Universitetin e Uashingtonit në Misuri.

Çmimi për ekonomi nuk është një prej pesë çmimeve të para që ishin ndarë më 1895, kur u krijua ndarja e Çmimit Nobel nga shpikësi i dinamitit, Alfred Nobel.

Çmimi Nobel për Ekonomi ka nisur që të ndahet nga viti 1969.





# Emërohet komandanti i ri i KFOR-it në Kosovë, zotohet për bashkëpunim

EPOKA  
ERE

MAL QORRAJ

PRISHTINË, 10 TETOR - Të hënën e 10 tetorit është ndërruar komanda e KFOR-it. Komandant i 27 i KFOR-it është gjeneralmajori italian Angelo Michele Ristuccia. Ai fjalimin e tij të parë në këtë pozitë e filloi duke i kujtuar të gjithë të rënë.

Ristuccia ka theksuar se sakrificat e tyre meritojnë angazhimin e tyre për të garantuar paqe, siguri dhe stabilitet. "KFOR-i është një histori suksesi dhe ky sukses është rezultat i përkushtimit të të gjithë atyre që, politikisht dhe në terren, kanë kontribuar për stabilitetin, sigurinë dhe lirinë e lëvizjes për të mirën e të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë dhe që kanë mbështetur zhvillimin e një dialogu konstruktiv ndërmjet palëve", ka pohuar ai.

Michele Ristuccia u zotua se me përkushtim të plotë do t'i përmbushë detyrat e tij të përcaktuara në këtë mandat. "Falënderoj Autoritetet Politike e Ushtarake Italiane dhe ato Shumëkombëshe që ma kanë besuar këtë detyrë. I siguroj ata se jam i vetëdijshëm për përgjegjësitë dhe sfidat e mëdha që duhet të përballen. Jam i sigurt për mbështetjen e tyre, por

i siguroj se këto sfida do t'i kthejmë në mundësi me transparencë, paanshmëri, vendosmëri, konsistencë me mandatin, në sinergji me Zyrën e BE-së në Kosovë dhe EUSR-në për Kosovën, EULEX-in, UNMIK-un, OSBE-në, dhe në konsultime të ngushta me organizatat e sigurisë së Kosovës, shefin e Mbrojtjes së Serbisë dhe aktorë të tjerë në rajon", ka deklaruar gjeneralmajori italian Angelo Michele Ristuccia.

Presidentja Vjosa Osmani, e cila mori pjesë së bashku me kryeministrin Albin Kurti në ceremoninë e ndërrimit të Komandës së KFOR-it, me ç'rast ka falënderuar për shërbimin e tij të deritashëm në Kosovë, gjeneralmajor Ferenc Kajarin dhe i ka uruar mirëseardhje gjeneralmajorit Angelo Michele Ristuccias.

Në fjalën e saj para admiralit Stuart B. Munsch, komandant i Komandës së Forcave të Përbashkëta Aleate të NATO-s në Napoli, strukturave drejtuese të KFOR-it dhe përfaqësuesve të institucioneve të Kosovës, presidentja Osmani ka theksuar se gjeneralmajor Ristuccia po e fillon misionin në vendin më pro NATO-s në botë. Sipas saj, Kosova është partnere e besueshme e Aleancës Veri-



Atlantike në të cilën synon të bëhet anëtare.

Osmani ka falënderuar mijëra gra e burra të KFOR-it të cilët kanë kontribuar dhe vazhdojnë të kontribuojnë për lirinë e lëvizjes, sigurinë dhe paqen prej 23 vjetësh. Sipas presidentes Osmani, ndërkohë që KFOR-i e ka reduktuar praninë e tij, Kosova ka forcuar kapacitetet

mbrojtëse dhe njëkohësisht po vazhdon partneritetin dhe koordinimin me forcat paqeruajtëse. "Në vitin 1999 NATO ndërhyri për ta ndaluar gjenocidin e vazhdueshëm që po kryhej kundër popullit të Kosovës. 23 vjet më pas ushtria jonë po shërben përkrah ushtrisë amerikane dhe vendeve të tjera partnere dhe po kontribuon në misionet paqeruajtëse në mbarë botën. Kosova ka qëndruar gjithmonë në anën e duhur të historisë dhe ne po e tregojmë këtë edhe një herë duke

qëndruar pranë popullit të Ukrainës, tani që paqja, demokracia dhe rendi i bazuar në rregulla ndërkombëtare janë sërish nën sulm", ka theksuar presidentja Osmani.

Sipas saj, falë kontributit të NATO-s, Kosova sot është një vend paqësor dhe prosperues. Ajo ka përsëritur qëndrimin se është interes shtetëror i Kosovës që të jetë pjesë e NATO-s, në funksion të mbrojtjes së sigurisë kolektive, vlerave demokratike, paqes e stabilitetit në vend, rajon dhe në nivel global.



## Kurti pret në takim admiralin Stuart B. Munsch

Kryeministri Albin Kurti ka pritur të hënën në takim komandantin e Komandës së Forcave të Përbashkëta Aleate të NATO-s në Napoli, admiralin Stuart B. Munsch.

Kurti rikonfirmoi gatishmërinë për thellim të bashkëpunimit ndërinstitucional në mes të Qeverisë së Kosovës dhe KFOR-it në shërbim të sigurisë së të gjithë qytetarëve të vendit tonë. Duke shprehur mirënjohje për punën, rolin dhe rëndësinë e KFOR-it në Kosovë, kryeministri

Kurti ritheksoi se ruajtja e sigurisë në Republikën e Kosovës është qëllim i përbashkët. Ai e njoftoi me progresin ekonomik, demokratik, social e të sigurisë në Kosovë.

Në këtë takim u theksua zotimi për angazhim dhe koordinim ndërmjet qeverisë, institucioneve të Republikës së Kosovës dhe Forcave paqeruajtëse të NATO-s në Kosovë (KFOR) në shërbim të paqes për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

## Ministri Mehaj dhe komandanti i FSK-së udhëtuan për në ShBA

PRISHTINË, 10 TETOR - Me ftesë të Asociacionit të Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara (AUSA), ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, së bashku me komandantin e FSK-së, gjeneralleteniant Bashkim Jashari, udhëtuan për në Uashington, për të marrë pjesë në Konferencën Vjetore dhe Panairin e Industrisë së Mbrojtjes "AUSA 2022". Përveç takimeve gjatë panairit me

përfaqësues të kompanive të industrisë amerikane të mbrojtjes, ministri Mehaj dhe gjeneral Jashari do të takohen edhe me drejtorin e Agjencisë së Bashkëpunimit për Sigurinë e Mbrojtjes (DSCA) dhe James Hursch, shefin e Byrosë së Gardës Kombëtare, gjeneral Daniel R. Hokanson. Gjithashtu, gjatë vizitës katërditore pritet të takohen edhe me personalitete të tjera

të larta politike e ushtarake si dhe përfaqësues të komunitetit shqiptaro-amerikan.

Vizita përkatëse e ministrit Mehaj dhe gjeneral Jasharit është shumë e rëndësishme për procesin e zhvillimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe shpreh fuqishëm partneritetin tonë shumë të ngushtë me ShBA-në në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.







# Komisioni Evropian përsërit se vizat për qytetarët e Kosovës duhet të hiqen

Komisioni Evropian pritet të konfirmojë përmes raportit të progresit se Kosova vazhdon t'i përmbushë kushtet për liberalizimin e vizave me vendet evropiane dhe se Komisioni mbetet në qëndrimin se vizat për qytetarët e Kosovës duhet të hiqen.

Një gjë të tillë Komisioni e ka shprehur edhe në një letër dërguar vendeve anëtare javën e shkuar në prag të diskutimeve që do të zhvillohen më 13 tetor në grupin punues për vizat në Këshillin e BE-së

**PRISHTINË, 10 TETOR** - Komisioni Evropian do të miratojë më 12 tetor paketën vjetore të zgjerimit dhe raportet e progresit për secilin nga vendet e përfshira në këtë proces. Sipas burimeve të BE-së në Bruksel, raportet e sivjetme do të jenë një përzierje e elementeve pozitive, por edhe e shqetësimeve për mungesë të progresit në disa fusha, si dhe e disa dështimeve.

Komisioni Evropian pritet ta përmendë nisjen e negociatave të anëtarësimit në BE me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut si zhvillimin kryesor pozitiv në procesin e zgjerimit të bllokut me rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Me vite këto dy shtete kandidatë kanë qenë në pritje të nisjes së negociatave, edhe pse, sipas Komisionit Evropian, i kanë pasur të përmbushura të gjitha kushtet.

Greqia ka hequr në verë

pengesën e fundit ndaj Maqedonisë së Veriut, e cila ka pasur të bëjë me disa mospajttime rreth gjuhës dhe identitetit. Rrjedhimisht është hapur rruga edhe për Shqipërinë, meqë dy vendet kanë qenë në paketë qysh në fillim.

Komisioni Evropian pritet të konfirmojë përmes raportit të progresit se Kosova vazhdon t'i përmbushë kushtet për liberalizimin e vizave me vendet evropiane dhe se Komisioni mbetet në qëndrimin se vizat për qytetarët e Kosovës duhet të hiqen.

Një gjë të tillë Komisioni e ka shprehur edhe në një letër dërguar vendeve anëtare javën e shkuar në prag të diskutimeve që do të zhvillohen më 13 tetor në grupin punues për vizat në Këshillin e BE-së.

Nga porositet politike për rajonin e Ballkanit pritet, po ashtu, që Komisioni të ftojë Kosovën dhe

Serbinë që të bëjnë përparim në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve, që do të çonte drejt arritjes së një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse.

Për pothuajse të gjitha shtetet e rajonit pritet të përsëritet thirrja për më shumë përparim në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, për forcimin e sundimit të ligjit, për reformat e gjyqësorit dhe për lirinë e medieve.

Ndonëse ka një lloj progresi në këto fusha, Komisioni Evropian vlerëson se në të shumtën e rasteve zbatim i reformave është në fazën fillestare.

Komisioni do të raportojë në këto dokumente edhe për sfidat e vendeve të rajonit në furnizimin me energji elektrike si dhe për bashkëpunimin e tyre me BE-në në këtë drejtim.

Kureshtja më e madhe e diplomatëve në Bruksel është se si do t'i formulojë Komisioni Evropian kritikën që do t'ia bëjë Serbisë për shkak të mospërshtatjes së qëndrimeve të saj me politikën e jashtme të BE-së, përkatësisht mosvendosjes së sanksioneve kundër Rusisë për shkak të pushtimit të Ukrainës.

Serbia është i vetmi vend i rajonit të Ballkanit dhe, krahas Turqisë, i vetmi vend i përfshirë në procesin e zgjerimit të BE-së

që nuk i ka mbështetur sanksionet e bllokut kundër Rusisë. Pritet që në raportin e progresit Komisioni ta shënojë këtë si dështim të Serbisë.

Një vend tjetër i rajonit, i cili do të ketë fokus të veçantë në paketën e zgjerimit këtë vit, është Bosnjë-Hercegovina.

Komisioni Evropian pritet të shprehë zhgënjim për dështimin e forcave politike në këtë vend për të arritur një marrëveshje për reformat e sistemit zgjedhor si dhe për reformat e kufizuara kushtetuese.

Për këtë shkak, në ditën e zgjedhjeve në këtë shtet, më 2 tetor, përfaqësuesi i lartë i bashkësisë ndërkombëtare për Bosnjë-Hercegovinën, Christian Schmidt, është detyruar t'i përdorë kompetencat e tij dhe të imponojë disa ndryshime.

Raportet vjetore të progresit analizojnë në detaje arritjet e secilit vend në fushat dhe kapitujt e negociatave të anëtarësimit në BE.

Vendet e rajonit ndodhen në faza të ndryshme në procesin e zgjerimit. Mali i Zi ka avancuar më së shumti dhe i ka hapur të gjithë kapitujt e negociatave. Serbia pason si shtet që është në procesin e negociatave, por këtë vit nuk ka hapur, deri më tash, asnjë kapitull të ri.

Shqipëria dhe Maqedonia e

Veriut sapo i kanë nisur negociatat, ndërsa Bosnjë-Hercegovina ka aplikuar për anëtarësim në BE, por ende nuk ka marrë mendim pozitiv nga Komisioni Evropian për dhënien e statusit të vendit kandidat.

Kosova është i vetmi vend i rajonit të Ballkanit Perëndimor i cili nuk ka aplikuar ende për anëtarësim në BE.

Qeveria e Kosovës ka paralajmëruar se do ta bëjë kërkesën formale këtë vit, por në BE nuk janë të sigurt se si do të veprojnë, pasi Kosova nuk është njohur si shtet nga pesë vende anëtare, ndërsa vendimet në procesin e zgjerimit merren me konsensus të plotë.

Turqia është një vend tjetër kandidat për anëtarësim në BE, për të cilin do të miratohet, po ashtu, raporti i progresit. Por, me këtë shtet, procesi i negociatave është i ngrirë dhe Komisioni, për disa vite radhazi, ka raportuar se Turqia ka shënuar këthim prapa për përmbushjen e kushteve për anëtarësim dhe përafrimin e saj me standardet evropiane.

Në qershor në procesin e zgjerimit janë përfshirë edhe tri shtete të fqinjësisë lindore evropiane. Ukraina dhe Moldavia kanë marrë statusin e vendit kandidat, ndërsa Gjeorgjisë i është premtuar "perspektiva evropiane".



# Marrëveshja finale Kosovë - Serbi po shihet e pamundur pa një përkushtim serioz të palëve

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 10 TETOR - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka publikuar analizën me titull "Elementet kyçe të nevojshme për progres në normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë: një perspektivë nga Kosova dhe nga Serbia", në tryezën e diskutimit të mbajtur në Beograd me pjesëmarrës përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile nga Kosova dhe Serbia.

Një nga autorët e kësaj analize, Visar Xhambazi, duke shpalosur këndvështrimin nga Kosova, tha se dialogu për normalizimin e marrëdhënieve duhet të përqendrohet fillimisht në drejtësinë tranzicionale, ballafaqimin me të kaluarën dhe ndërtimin e narratives së duhur të palëve ndaj njëra-tjetrës. Ai shtoi si elemente të nevojshme zbatimin e marrëveshjeve të dialogut nga të dyja palët, duke

përfshirë edhe zbatimin e aktgjyqimeve të gjykatës kushtetuese nga ana e Kosovës. Si element tjetër kyç për progres në normalizimin e marrëdhënieve, ai listoi nevojën që BE-ja t'u ofrojë perspektivë të qartë evropiane Kosovës dhe Serbisë si inventivë për të lëvizur përpara me dialogun dhe përafrimin e palëve të marrëveshja përfundimtare. Për më tepër, koordinimi BE - ShBA dhe i emisarëve specialë për dialogun mbetet i rëndësishëm për procesin e dialogut. Ndërsa, sipas tij, këto të fundit duhet të ushtrojnë presion ndaj Serbisë për përafrim me politikat e BE-së dhe vendosjen e sanksioneve ndaj Rusisë si shprehje e vullnetit pro evropian.

Në anën tjetër, autori nga Serbia, Milos Pavković, theksoi që palët duhet të jenë të hapur ndaj dialogut, duke vendosur në rend të parë interesat e qytetarëve. Ai shtoi se palët duhet ta zhvillojnë dialogun në mirëbesim, duke u



përmbytur nga gjuha që nxit tensione në terren dhe nga deklaratat populiste. Përveç kësaj, Pavković theksoi se Kosova dhe Serbia duhet t'i zbatojnë marrëveshjet tashmë të arritura për të cilat duhet të ndërtohet një mekanizëm i monitorimit të

zbatimit, kurse palët duhet ta mbështesin njëra-tjetrën në rrugën e tyre integruese dhe të synojnë në dialog arritjen e një kompromisi që çon drejt normalizimit të marrëdhënieve dhe marrëveshjes përfundimtare.

Ndërsa transparenca e procesit të dialogut u listua si një nga elementet thelbësore edhe nga të pranishmit në këtë diskutim, që i ka munguar deri më tani këtij procesi, e cila duhet të garantohet në bazë të normave demokratike.

## Në Ushtrinë e Kosovës mbi 11 për qind janë gra



PRISHTINË, 10 TETOR - Irfete Spahiu, e cila në FSK mban gradën e generalmajorit, ka thënë se Forca e Sigurisë së Kosovës është ndërtuar sipas standardeve të NATO-s.

Sipas saj, roli i grave në luftë dhe në paqe është i patjetërsueshëm, duke shtuar se në FSK janë mbi 11

për qind gra ushtarë. "Është e trishtueshme që shumica e luftërave shkaktohen nga burrat, por peshën më të madhe e bëjnë gratë. Gratë u lanë pas për t'u përkujdesur për fëmijët, për punët e shtëpisë. Gratë dhunoheshin, vriteshin si fushatë e spastrimit etnik. Kjo nuk ka

ndodhur vetëm në Kosovë, por në shumë vende të botës. FSK-ja është forcë e ndërtuar sipas standardeve me NATO-n. 11.3 për qind është pjesëmarrja e grave në FSK tash. Mund të mos jetë numri i madh, por të gjitha e kanë kaluar procesin si kolegët e tyre meshkuj. Gratë kanë qenë pjesë

edhe e çlirimit dhe kanë ndihmuar edhe në themelimin FSK-së", ka thënë Spahiu. Ajo këto komente i bëri gjatë ditës së tretë të punimeve të Seminarit të 102-të Rose-Roth të Asamblesë Parlamentare të NATO-s. Spahiu shtoi se gratë janë pjesë kritike e shoqërisë, prandaj edhe

duhet të jenë pjesë kritike e proceseve paqeruajtëse. "Vajzat dhe gratë në FSK kanë trajtim të barabartë me kolegët e tyre. FSK-ja edhe është zgjedhur institucioni më i besueshëm në Kosovë. Kontributi i grave nuk është kuota, por vlerë e shtuar", ka thënë Spahiu.



## Fillojnë punimet në Parkun Linear në lagjen e spitalit

PRISHTINË, 10 TETOR - Drejtoresha e Menaxhimit të Hapësirave Publike në Prishtinë, Donika Çetta,

bashkë me nënkryetarin e komunës së Prishtinës, Alban Zogaj, kanë vizituar punimet e sapofilluara në

Parkun Linear, përgjatë dhe anash rrugës "Vëllezërit Dehari". Implementimi i projektit

ka filluar më 3 tetor dhe supozohet të përfundojë brenda 90 ditëve.



## Komuna e Skenderajt vazhdon t'i përkrahë fermerët

SKENDERAJ, 10 TETOR - Komuna e Skenderajt po vazhdon përkrahjen për fermerët për veprimtari të ndryshme bujqësore. Kjo komunë ka shpërndarë 70 koshere bletësh për sektorin e bletarisë për përfituesit e përzgjedhur nga konkursi publik i shpallur kohë më parë.

Drejtori për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Behxhet Maliqi, i ka përgëzuar bletarët e komunës së Skenderajt për pajisjet e përfituara nga programi për zhvillimin e bujqësisë,

duke siguruar se qeverisja nën drejtimin e Nurës do të vazhdojë të ofrojë përkrahje edhe për sektorët e tjerë të bujqësisë.

Ai ka theksuar se numri i përfituesve të pajisjeve të ndryshme bujqësore sa vjen e rritet në komunën e Skenderajt.

Maliqi ka thënë se brenda dy jave kjo është faza e pestë e shpërndarjes së pajisjeve dhe mekanizmave të ndryshëm bujqësorë me qëllim që të përkrahën bujqit dhe të ndihmohet zhvillimi i bujqësisë.



## Vendoset gurthemeli i xhamisë së re në Lipjan

LIPJAN, 10 TETOR - Kryetari komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti, së bashku me kryetarin e Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan, Zaim Baftiu, myftiun e Bashkësisë Islame të Kosovës, Naim Tërnava dhe zëvendës drejtorin gjeneral të organizatës "Katar Charity", Nawaf Al Hammadi, kanë vendosur gurthemelin e xhamisë së re në Lipjan.

Kryetari Ahmeti ka theksuar se është ndjenjë e veçantë vendosja e gurthemelit të xhamisë së re në Lipjan pasi, sipas tij,

qytetit po i shtohet edhe një objekt i bukur që kompletion infrastrukturën e nevojshme për besimtarët islamë. "Qyteti ynë çdo ditë e më tepër po bëhet atraktiv dhe po popullohet andaj, duke u rritur qyteti, rritet edhe nevoja për këso objekte. Urime të gjithë komunitetit mysliman në Lipjan! E gëzofshim këtë xhami!", ka thënë Ahmeti. Prona për këtë xhami është ndarë nga Kuvendi i Komunës, ndërsa xhamia do të ndërtohet nga donacioni i organizatës "Katar Charity".

## Komuna e Mitrovicës bën shpërndarjen e 216 koshereve dhe 27 centrifugave për bletë për fermerët

MITROVICË, 10 TETOR - Komuna e Mitrovicës, përkatësisht Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, në kuadër të projekteve për mbështetje të fermerëve, gjatë ditës së sotme ka nënshkruar kontratat me 27 fermerët përfitues të cilët janë subvencionuar secili prej tyre me nga 8 koshere dhe një centrifugë për bletë.

Me rastin e nënshkrimit të kontratave i pranishëm ishte drejtori i Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Ferdi Kadriu, i cili i ka uruar të gjithë fermerët përfitues të këtyre pajisjeve, duke u thënë atyre se mbështetja për

fermerët nuk do të ndalet dhe se për vitin 2023 janë planifikuar gjithsej 350 mijë euro investime në sektorin e bujqësisë.

Drejtori Kadriu është shprehur i kënaqur me mbarëvajtjen e përzgjedhjes së këtyre fermerëve, duke theksuar se procesi është realizuar gjithmonë sipas procedurave të parapara dhe falë punës së palodhshme të stafit të drejtorisë.

Vlen të potencohet se vlera e përgjithshme e këtij projekti është 12 500 euro, ku komuna e Mitrovicës ka participuar 80 për qind, ndërsa fermeri 20 për qind.



## Mbi 300 studentë nga Malisheva përfitojnë bursë për vitin 2022

MALISHEVË, 10 TETOR - Kryetari i komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati, ka bërë me dije se pas një pune të shkëlqyeshme të komisionit për ndarjen e bursave për vitin 2022, tashmë është bërë publike lista e mbi 300 studentëve përfitues. "Me

kënaqësinë më të madhe ju informoj se ky është numri më i madh i përfituesve të kësaj burse që i kemi përkrahur si komunë. Përfitues janë të gjithë studentët e komunës së Malishevës të cilët i kanë plotësuar kriteret ligjore. Si kryetar i komunës së

Malishevës ju siguroj se, ashtu siç jemi zotuar, edhe po vazhdojmë t'i jetësojmë politikën e qeverisjes sonë komunale për t'i përkrahur studentët tanë që vijojnë studimet nëpër universitetet publike të vendit tonë", ka thënë Kastrati.





# PDK-ja shënon 23-vjetorin e themelimit pa themeluesit e saj

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, nëpërmjet një videoadresimi ka uruar 23-vjetorin e themelimit të kësaj partie, duke thënë se PDK-ja u ka prirë proceseve të lirisë, pavarësisë dhe shtetndërtimit. Krasniqi ka theksuar se PDK-ja do të ofrojë një alternativë qeverisëse për të gjithë

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 10 TETOR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, nëpërmjet një videoadresimi ka uruar 23-vjetorin e themelimit të kësaj partie, duke thënë se PDK-ja është forca që ka ndjekur dhe ka jetësuar ëndrrat për Kosovën. Krasniqi ka rikujtuar se PDK-ja u ka prirë proceseve të lirisë, pavarësisë dhe shtetndërtimit. "Themeluesit dhe udhëheqësit tanë historikë, në luftën për liri dhe pavarësi, bashkë me popullin, realizuan ëndrrën shekullore të shumë brezave. Po! PDK punoi fort e pa ndal për ndërtimin e shtetit dhe për mirëqenien qytetare. Unë dhe të gjithë ne në Partinë Demokratike të Kosovës jemi shumë krenarë që jemi pjesë e kësaj familjeje të madhe politike", ka thënë lideri i PDK-së. Krasniqi theksoi se tani PDK-ja është e gatshme për t'i krijuar kushtet për një shoqëri të drejtë për të gjithë, ku të rinjtë do të gjejnë perspektivë në Kosovë. "Ne jemi të parët që do të zbatojmë formulën përfaqësuese 50 për qind me 50 për qind në mes të grave dhe burrave. Kemi ristrukturuar organizimin nga degët e deri në nivelin qendror. Kemi formuar Kabinetin për Qeverisje të Mirë me ekspertë të dëshmuar dhe i kemi dhënë rinisë edhe më shumë hapësirë në vendimmarrje", shtoi ai. Krasniqi është zotuar se PDK-ja do të ofrojë një alternativë qeverisëse për të gjithë. "Një

sistem arsimor më të mirë për fëmijët tanë, vende të punës të paguara mirë, sigurime shëndetësore për të gjithë, të drejta të mbrojtura për punëtorët edhe në sektorin privat, mbështetje konkrete për ndërmarrësit dhe bizneset vendore, ambient të sigurt për secilin qytetar dhe mundësi të barabarta për të gjithë - këto janë shtyllat për Kosovën tonë të re, si vend modern e i zhvilluar. Kjo tani është beteja për të ardhmen tonë. Ky është zotimi ynë për Kosovën tonë. Partia Demokratike e Kosovës është gati!", u shpreh Krasniqi. Ndërkaq Enver Hoxhaj ka thënë se 10 tetori 1999 nuk është një datë e zakonshme në kalendarin e historisë më të re të Kosovës. "Është lindja e Partisë Demokratike e Kosovës, e formësuar nga sakrificat e popullit, paraprirëse e pavarësisë dhe shtetndërtimit. Është ngushtë e lidhur me çdo arritje dhe sfidë të Kosovës. PDK-ja është Kosova! PDK-ja është vetë Hashim Thaçi, është vetë Kadri Veseli - themeluesit që e vazhdojnë edhe sot 23 vjet më vonë sakrificën e tyre për lirinë e Kosovës. Deri në kthimin e tyre, PDK-ja do të vazhdojë ta përmbushë misionin e saj jo vetëm politik, por edhe të arritjeve tona historike! Partia Demokratike e Kosovës asnjëherë nuk do të heqë dorë për rikthimin e plotë si parti më madhe, si shpresa dhe besimi i vetëm pse ekzistojmë si parti!", ka shkruar Hoxhaj në "Facebook".



## PDK-ja themelon Këshillin Politik, drejtohet nga Arsim Bajrami

Në 23-vjetorin e themelimit të partisë, kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, me vendim të kryesisë, ka themeluar të hënën Këshillin Politik, një organ këshillëdhënës i partisë. Këshilli Politik ka 31 anëtarë, ndërsa përbëhet nga koordinatori dhe 30 anëtarë të partisë. Koordinator i Këshillit Politik do të jetë akademik Arsim Bajrami, ndërsa anëtarë të Këshillit janë: Agim Çeku, Agim Zogaj, Avni Kastrati, Bajram Mulaku, Basri Musmurati, Daut Xhemali, Drita Kadriu, Fadil Beka, Flora Brovina, Gani Koci, Hasime Krasniqi, Ismail Sylja, Kadri Kryeziu, Latif Gashi, Laura Guguli, Lumnie Morina, Lumnie Rama, Mehdi Bektashi, Mexhide Topalli, Minir Krasniqi, Ramadan Muja, Ramiz Fazliu, Sabri Tahiri, Sala Ahmeti, Salie Mustafa, Selvie Halimi, Shaban Shabani, Shemi Veseli, Skender Ahmeti dhe Zahrie Isufi. Anëtarët e këshillit janë

personalitete që kanë kontribuar në Partinë Demokratike të Kosovës që nga themelimi i saj, në pozicione dhe kapacitete të ndryshme - si deputetë, kryetarë komunash, ministra, themelues të partisë etj. Në mbledhjen konstituive të Këshillit Politik, kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, i ka falënderuar të gjithë anëtarët e këshillit për punën e tyre që nga themelimi i partisë e deri sot, ndërsa i ka ftuar që përvojën e tyre politike të vazhdojnë ta japin tani nëpërmjet punës në Këshillin Politik për të ardhmen e gjeneratave të reja. "Në këtë ditë të shënuar të 23-vjetorit të themelimit të Partisë Demokratike të Kosovës, po konstituojmë edhe Këshillin Politik, i cili është një organ këshillëdhënës statutar i PDK-së dhe që përmbledh një numër të jashtëzakonshëm të personaliteteve të rëndësishme të të gjithë rrugëtimit të PDK-së, të cilët që nga themelimi e tutje kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm kombëtar, institucional e politik në detyra të ndryshme udhëheqëse brenda PDK-së, por edhe në institucionet e nivelit qendror dhe nivelit lokal. Për mua ishte vërtet një ndjenjë e nderit të madh, sepse kam punuar

me shumë prej tyre dhe ruaj respektin dhe konsideratën maksimale duke e ditur nga dora e parë kontributin e tyre të jashtëzakonshëm", ka deklaruar Krasniqi. Ndërsa koordinatori i Këshillit Politik, Arsim Bajrami, shprehi falënderim për besimin e dhënë për udhëheqje të këtij organi, i cili do ta këshillojë dhe ndihmojë lidhshimin e partisë. "Si një prej themeluesve të parë të PDK-së, jam jashtëzakonisht nderuar me propozimin e kryetarit dhe kryesisë për të qenë pjesë e Këshillit Politik, sidomos në këtë kohë kur udhëheqja e re dhe lidhshimi i partisë është duke punuar jashtëzakonisht mirë për reformimin e partisë për ta kompensuar edhe mungesën e madhe të dy liderëve, themelues dhe historikë", ka theksuar Bajrami. Kompetencat e Këshillit Politik të PDK-së do të jenë t'i ndihmojë organet qendrore të partisë (Kryetarin, Kryesinë dhe Këshillin Drejtues) me këshilla, rekomandime, analiza dhe ide, të prodhojë dokumente për nevoja të partisë, të jepë rekomandime për përmirësimin e akteve juridike të partisë dhe mënyrës së funksionimit efikas.





ISH LIDERI STUDENTOR I '97-'99, MUHAMET MAVRAJ, FLET PËR VIZITËN NË HAGË NË EMISIONIN "FRONTAL" TË TELEVISIONIT T7

# Mavraj: Ata në Hagë janë top fare, ndërsa Gjykata Speciale është parti speciale

## Mavraj: Dy binarët e politikës anti-UÇK të nisur në 2010 u takuan në vitin 2019

FRONTAL, Muhamet Mavraj - 03.10.2022



LIVE



Në studio: Muhamet Mavraj, publicist

### TAKIMI ME ISH-KRERËT E UÇK-SË, ÇFARË PO BËN SHTETI NË MBROJTJE TË TYRE?

Ish lideri studentor i '97-'99, Muhamet Mavraj, flet në emisionin "Frontal" të Televizionit T7, te gazetari Arsim Lani, për vizitën që u bëri krerëve shtetërore të Kosovës dhe të UÇK-së në Qendrën e Paraburgimit në Hagë pikërisht në ditën e 25 vjetorit të fillimit të rezistencës paqësore aktive të shqiptarëve të Kosovës ndaj pushtimit serb, më 1 tetor. Mavraj ka folur edhe për përputhjen e politikës aktuale, tërësisht anti-UÇK me atë politikës që ia imponoi Kosovës Gjykatën Speciale, si politikë e dy binarëve të vitit 2010 që takohen në vitin 2019/20.

**Frontal:** ...Dhe, për ata që ndodhen në Dhomat e Specilizuara, pra në Qendrën e Paraburgimit në Hagë, do të flasim edhe në pjesën e dytë të emisionit "Frontal", sepse para dy ditësh, ish krerët e lartë të UÇK-së i ka vizituar Muhamet Mavraj, të cilin unë e kam ftuar

në studion e emisionit "Frontal". Zotëri Mavraj mirë se erdhët...

**Mavraj:** Mirë se ju gjeta, faleminderit për ftesën!

**Frontal:**... Faleminderit shumë që pranuat të vini në T7 dhe të ndajmë bashkë me ne dhe me teleshikuesit e T7 përvojën tuaj me takimet që keni pasur me ata që ju i keni...

**Mavraj:** Patjetër.

**Frontal:** ...me shokët tuaj në Hagë

**Mavraj:** Me dëshirë të shumëfishtë, edhe për shkak të atyre por edhe për shkak të respektit ndaj jush, juve personalisht dhe televizionit tuaj...

**Frontal:** ...dhe shikuesve që po na ndjekin

**Mavraj:** Patjetër

**Frontal:** E aq më tepër që ju i keni pasur dhe vazhdoni t'i keni

miq ata të cilët ndodhen në Qendrën e Paraburgimit në Hagë...

**Mavraj:** Po, përfshirë juve si miq...dhe disa nga ish punëtorët e mi që tani janë në T7 por edhe disa studentë që me kënaqësi i takoj sa herë që vij te ju.

**Frontal:** Si kaluat në Hagë?

**Mavraj:** Mirë, por ka qenë kjo një ditë tjetër kjo në krahasim me një përjetim që do ta kisha përpara ose më vonë. Ka qenë 25-vjetori i protestave studentore dhe këtë 25-vjetor kam vendosur ta kaloj me të gjithë të burgosurit tanë që janë në Hagë, faktikisht me gjashtë prej tyre. Dy nuk arrita t'i shoh, por herën tjetër, shpresoj se nuk do të këtë herë tjetër, por nëse ka herë tjetër do t'i takoj edhe ata.

**Frontal:** Kë e takuat?

**Mavraj:** Të gjithë këta katër kryesorët që janë në një

aktakuzë. Të parin e kam takuar Rexhep Selimin. Nasim Haradinajn, jashtë protokollit. Pastaj, pas një ore tjetër kam takuar Kadriun. Pastaj prej 11 deri në 12:15 bacën Jakup. Pas këtij takimi kemi pasur një pauzë të drekës dhe prej orës 13:30 deri në 16:00 jam takuar me Hashim, më së shumeti me të.

**Frontal:** Dmth brenda një ditë i keni realizuar të gjitha këto takime?

**Mavraj:** Po, brenda një dite janë realizuar të gjitha këto takime. Natyrisht, shkurtimisht me Nasimin dhe Hysni Gucatin. Saliun dhe bacën Pjetër nuk arrita t'i shohë, por ju kam përcjellë të fala.

**Frontal:** Ju keni thënë se po ju dërgoj të falat (e publikut) atyre që janë në Hagë, para së të takoheni me ta, kështu postuat në facebook...?

**Mavraj:** Para se të hy atje

brenda, për shkak se do i kishim të ndaluar telefonat, e kam bërë një postim në "Facebook" ku kam thënë se po hy dhe për çfarë po hy në vizitë dhe për ditën e 1 tetorit, ua kam uruar njerëzve, pra 25-vjetorin e protestave studentore, si jubile i rëndësishëm, por nuk po e kaloj me juve, por me këta këtu në burg.

**Frontal:** Qysh kalove? Qysh ishin? Zakonisht kur të shkosh për vizitë diku dhe kur të kthehesh të pyesin qysh ishin?

**Mavraj:** "Shëndosh e mirë në burg"! Por, ato që i kam thënë me një fjali, pas mbarimit të vizitave, se këta janë brilantë dhe unikë, qëndrojnë.

**Frontal:** Çfarë nënkupton se ata janë unikë? Ata mund të qëndrojnë unikë për shkak të rrethanave...

**Mavraj:** Jo, ka shumë raste kur të burgosurit nuk janë unikë edhe pse mund të qëndrojnë në



një dhomë. Ata janë unikë në kuptimin e perceptimit të situatës, aktakuzës, kontekstit politik që i ka dërguar atje, rrethanave të përgjithshme politike, por edhe unikë në kuptimin e mbrojtjes së vlerave të UÇK-së, bartës të cilave janë pikërisht ata – kryesorët, dhe më pastaj rangjet tjera. Ata janë shumë të vetëdijshëm kush janë dhe pse janë aty, pavarësisht se njëri prej tyre është shprehur se ende nuk e di pse është atje. Baca Jakup disa herë e tha se i ka lexuar të gjitha materialet dhe nuk e di pse me mbajnë këtu. Bindja ime ishte, ia thash. se po të mbajnë për shkak se je anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së dhe jo për ndonjë gjë tjetër sepse kot janë duke u mbajtur të gjithë. Ju e dini se ata nuk akuzohen asnjëri se kanë marrë pjesë në ndonjë lloj krimi, çfarëdo qoftë ai, pavarësisht propagandës së formuluar nga ai farë Jack Smith-it dhe prokurorët tjerë dhe propagandës që i pason ata. Të gjithë këta janë të akuzuar si autoritete përfundimtare të UÇK-së, pra në bazë të zinxhirit komandues. E ky zinxhiri komandues e përfshinë një fjalë bazike atje në ligj që të gjithë këta e dinin ose kishin arsyeje për ta ditur që ka ndodhur një krim kushedi se ku në Kosovë, në cilëndo periudhë gjatë luftës ose për absurd edhe pas luftës ku këta pushtetin e kanë pasur të barabartë me zero. Pra, nuk kanë pasur fare pushtet pasluftës.

**Frontal:** Qysh ish ajo ndjenja ose përjetimi kur shkon dhe i takon në burg? Po them brenda grilave edhe pse aty nuk duket si i tillë, ata të cilët deri dje kanë qenë udhëheqës...

**Mavraj:** Kur kam qenë në vitin 2004 në Hagë për vizitë të Fatmir Limaj, atëherë kam qëndruar dy ditë nga tetë orë. Dhe sa e mbajë në mend kemi kaluar në shtatë dryna. Këta kishin pak më shumë...

**Frontal:** Pak më shumë?

**Mavraj:** Pak më shumë dhe si ndjenjë sigurisht nuk është e mirë, por shqiptarët janë mësuar ta përballojnë atë lloj ndjenje. Por, një lloj ndjenje poshtërimit këta e ndjenjë, jo për shkak të kësaj shumësisë së drynave, por për shkak të mënyrës se si janë përpjekur ta ndërtojnë kundër tyre narracionin akuzues, 90 për qind i bazuar në rrëfime serbe, për fat të keq. Ata që kërkojnë një lloj mbikëqyrje ose që shprehin kritika a ankesa për këtë gjykatë sepse është jashtë kontrollit, unë ju them se ajo është plotësisht nën kontroll, por jo të Kosovës. Është tërësisht nën kontrollin serb, tërësisht. Në bazë të asaj që kemi parë, kemi lexuar dhe që kemi dëgjuar, në bazë të shkresave zyrtare, në bazë të pohimeve të avokatëve dhe të

vetë këtyre e kështu me radhë, ata (prokurorët) kanë marrë dhe vazhdojnë të marrin "fajllat" serb, do të thotë dosje serbe, përfshirë dëshmitarë serbë që kanë udhëhequr masakra kundër fëmijëve dhe grave shqiptare, në përgjithësi të civilëve shqiptarë në Kosovë gjatë luftës, sidomos gjatë periudhës 98-99. Dhe siç do ta shihni pastaj kur do të fillojë ky proces nëse këto vërtet i përdorin gjatë shqyrtimit gjyqësor do të krijojë një indinjatë shumë-shumë të thellë çështja e kësaj gjykate, ndoshta edhe te shqiptari më i ligë do të zgjojë një indinjatë çështja e kësaj gjykate, e cila me të vërtetë ka devijuar tërësisht nga sistemi i Kosovës, tërësisht nga misioni që e ka.

**Frontal:** Do të flasim për mënyrën se si funksionon Gjykata Speciale edhe për ata se a po bëjnë mjaftueshëm institucionet e Republikës së Kosovës për ta mbrojtur përmes këtyre udhëheqësve luftën e UÇK-së. Po ashtu edhe për atë se çfarë po bën shteti shqiptar që siç duket po bën më shumë sesa Kosova, por po me interesojnë takimet që kishite...sepse po besoj se edhe shikuesve iu intereson...

**Mavraj:** Pyet çfarë të duash...

**Frontal:** ...dhe përgjigju aq sa të lejohet të përgjigjesh...

**Mavraj:** Aq sa më lejohet do ta them...

**Frontal:** ...se kur kam biseduar me tjerët kanë thënë se nuk kanë të drejtë të flasin gjithçka, por... Si shkojë takimi me Hashim Thaçin?

**Mavraj:** Shumë mirë.

**Frontal:** Çfarë thoshte?

**Mavraj:** E para e punës e kishte marrë malli shumë. Është i vetmi që ma ka thirr emrin shumë larg tu ardhur të dhoma e vizitave, qysh thërrasin në katund kur t'i shkon dikujt... Njëjtë i jam përgjigjur, byjrum këtu jam. Edhe...mund të them se e ka një gjykim shumë të saktë. Me tha se është duke iu shmangur lajmeve ditore...

**Frontal:** Lajmeve ditore?

**Mavraj:** Lajmeve ditore, ngjarjeve ditore...

**Frontal:** Ka mundësi të lexojë apo vetëm të shikojë?

**Mavraj:** Po, ka mundësi sepse janë dy-tri televizione të Kosovës, janë disa kanale të Shqipërisë, ka kanale ndërkombëtare të mjaftueshme. Kanë të drejtë ta lexojnë një gazetë të Kosovës, por me një ditë vonësë, dhe dy gazeta ndërkombëtare më duket, e kanë zgjedhur "New York Times" ata, dhe prej vendoreve është "Epoka e re" dhe një tjetër me duket e Shqipërisë.

**Muhamet Mavraj**  
1 Tetor në 8:06 PM · 🌐

Ju pershendes nga Haga!

Urime 25 vjetorin e protestave studentore te 1 tetorit 1997!

Ne kete jubile sot do te perqafohem me strategjet e lirise dhe pavaresise se Kosoves. Nga te gjallet, ne kete 25 vjetor, askush me shume sesa keta nuk meriton respektin dhe perkrahtjen. Te falat Tuaja po ua percjelli! E di se i pershendesni 😊



👍 Ti, Berat Dakaj, Mal Qorraj dhe 1,6 mijë të tjerë

319 komente 35 ndarje

**Frontal:** D.m.th ata e lexojnë "Epokën e re"?

**Mavraj:** Po, po, por me një ditë vonësë. Ajo u shkon e printuar në versionin "pdf", që do të thotë se duke i pasur të gjitha këto kanale, përfshirë diçka si tekste të shkruara, pra gazeta, mjaftueshëm janë të informuar, por jo entuziastë për të komentuar ngjarjet ditore ose çështje të caktuara ditore.

**Frontal:** Thatë se Thaçin e kishte marrë malli! E kishte marrë malli për ty apo për Kosovën-njerëzit e Kosovës?

**Mavraj:** Mbase të dyjat. S'e di njerëzit sa e kuptojnë dhe sa e besojnë. Këta kur janë në qeveri nuk ju shkoj kurrë. Që nga koha kur Limaj ka qenë në Hagë, unë faktikisht nuk kam nejtë me të më kurrë (me Thaçin), përjashtimisht në raste të ngushëllimeve në familje në të cilat më kanë ardhë gjithmonë dhe ju kam shkruar, sigurisht. Për fat të mirë ky (Thaçi) nuk ka pasur rast për ngushëllime, por që të gjithë këta kur janë në vështirësi, në luftë ose në burg mua me kanë aty për çfarëdo që kërkohet dhe kjo vlen për të gjithë, edhe për ata që kanë qenë me përpara në burg, siç është rasti i Limajt...

**Frontal:** Këtë e keni dëshmuar! Edhe mediumi që udhëhiqeni e ka dëshmuar këtë...

**Mavraj:** Kjo vlen edhe për Albinin, sidomos për ato akuzat e rënda për vrasje në vitin 2007 të cilat nuk ishin të tij, por të UNMIK-ut. Kemi treguar një solidaritet të jashtëzakonshëm pavarësisht presioneve dhe gjithçka që na ka ndodhur, por kur del prej burgu ose kur ngjiten në qeveri, kapito, fund, nukshkoj...

**Frontal:** Zakonisht tek ne është e kundërta, kur dikush është në pushtet ne i ofrohemi më shumë...

**Mavraj:** Jo, tek unë është e kundërta. Kjo vlen edhe për Albinin, ka vlejtur edhe për Hashimin. Katër vjet ka udhëtuar dekorata e tij për të ardhur tek unë. Tash ka ardhur.

**Frontal:** Dekorata që ka ndarë presidenti për...

**Mavraj:** Po, dekorata për 10-vjetorin e pavarësisë.

**Frontal:** Çfarë i interesonte presidentit për Kosovën dhe për jetën jashtë burgut?

**Mavraj:** Në përgjithësi situata e përgjithshme, por pak më shumë fokusimi tek logjika e aktakuzës, propaganda e prokurorisë dhe tek qe ky narracioni që ata (prokurorët) janë duke u përpjekur ta ndërtojnë, sigurisht ndihen të poshtëruar kur si krerë të UÇK-së ose të shtetit të Kosovës, Presidencës, Kuvendit dhe Qeverisë e kështu me radhë, ata atakohen me materiale të regjimit serb që për ta, në bindjen time, është ekuivalent i akuzave që do t'ua bënte Hitleri hebrenjve. Ky absurd është që e ka gjetur këtë Evropë kështu qysh e ka gjetur. Përshtypja e përgjithshme është se ata të Bashkimit Evropian e ndajnë një lloj demotivimi pas luftës në Ukrainë sepse konteksti i formimit të Gjykatës Speciale ka qenë për përmbushjen e disa apetiteve serbe e kështu me radhë edhe pse ka qenë krejtësisht formulim serbo-rus. Siç e dini ata (serbo-rusët) kanë investuar shumë me emra e mbiemra e me... Ata thirren në Dick Martyn e kështu me radhë. Dhe tani kjo nuk është diçka që nuk është jashtë

fokusit të vështrimit, pikëpamjeve dhe shqetësimit të këtyre njerëzve që janë në burg.

**Frontal:** E ka përmendur Blendi Fevziu pas vizitës që e ka pasur në Hagë që i ka thënë Hashim Thaçi dmth., që i vetmi kontakt me botën është kur aeroplanët fluturojnë mbi burgun ku ata janë duke qëndruar...

**Mavraj:** Jo, ajo është metaforë. Këta nuk e kanë më këtë të vetmin kontakt sepse kanë medime dhe atë postimin e dytë në facebook që e kam bërë pas përfundimit të vizitave e kam përmendur fjalën "pelegrinazh" dhe ata që presin pelegrinët nuk janë më pa kontakt me botën e jashtme dhe me të vërtetë kështu siç këta po i mbajnë kot dhe aq fort padrejtësisht aty brenda, pavioni i tyre ku janë të burgosurit tanë të Kosovës, se aty ka shumë të tjerë nuk ka vetëm pavion të Kosovës, po kthehet në një vend pelegrinazhi. Pelegrinazhi është një vend i rrallë, i rëndësishëm se veçantë ku të paktën një herë në jetë ia vlen të shkosh ose vend ku njerëzit kanë dëshirë të shkojnë. Kjo është duke ndodhur, sepse ai vend është i vërsuar me vizita. Kapacitetet dhe mundësit që i kanë të lejuara sipas ligjit deri në dhjetë dite në muaj dhe brenda dhjetë ditëve mund të jenë 100 veta e më shumë në vizitë (tek një i paraburgosur). Këto mundësi që janë, ata janë duke i shfrytëzuar maksimalisht dhe faktikisht kjo është duke ndodhur. Ata bëjnë më shumë vizita-takime sesa unë dhe ti këtu në Prishtinë ku jemi në gjendje të lirë. Takimet atje janë të rëndësishme se veçantë për ta se nuk kanë kohë për këndo... →



**Frontal:** A ishin lodhur?

**Mavraj:** Jo nuk ishin lodhur. Ata e dinë ku janë dhe e kanë përshtatur sistemin e tyre që i përballon 50 vjet burg, së paku. Atë përshtypje e kam krijuar. Janë shumë mirë në gjendje psiko-fizike. Ata e kanë programin shumë të mirë që ia kanë përshtatur vetes, dikush me sport, dikush me lexim, poezi e pikturë...

**Frontal:** Dëgjova se Rexhep Selimi po pikturonte në burg...

**Mavraj:** Po, po pikturonte. Unë jam çuditur pak. Si poetë jemi njohur në vitin 1994. Unë e pata botuar një libër me poezi dhe ai të tijin që ma dhuroi në atë kohë në Prishtinë. Për pikturë s'e kam ditur dhe do të jetë një ekspozitë këtu në Kosovë. Do të shkojë më shumë kënaqësi.

**Frontal:** A pate rast t'i shohësh pikturat?

**Mavraj:** Jo, nuk i pashë se nuk i kishte me vete, por ekspozita do të mbahet në Prishtinë dhe do të shkojë. Besoj se do të vini edhe ju.

**Frontal:** Po patjetër do të jem aty, por unë ende nuk kam shkuar në Hagë, por do të shkojë...

**Mavraj:** Besoj se të mirëpresin...

**Frontal:** Edhe pse nuk kam shkuar ende kam dëshirë të dijë për ta gjithçka për ta brenda. Takimi me Rexhep Selimin...

**Mavraj:** Si miq të vjetër që jemi, takimi ka shkuar jashtëzakonisht shumë shpejt sepse ishte vetëm një orë dhe u tret shumë-shumë shpejt. Rexha edhe gjatë luftës e ka pasur një gjykim të mbrehtë të rrjedhave-ngjarjeve dhe mu duk i njëjti vetëm se tani më i pushuar dhe i predispozuar për analiza më të thella të ngjarjes. Ai e dinë psh. se ajo aktakuzë është përmbledhje e aktakuzave të përparme këtu në Kosovë ku shumica prej tyre kanë dështuar dhe tani ua bartin këtyre si autoritet më i lartë i UÇK-së në kuptimin e përgjegjësisë komanduese, zinxhirore, jo diçka tjetër. As ai dhe as të tjerët nuk akuzohen për asnjë lloj krimi të kryer drejtpërdrejt, por vetëm si përgjegjësi e lartë komanduese.

**Frontal:** Për z. Jakup Krasniqin kam dëgjuar nga Behgjet Pacolli se është pak i rënduar nga shëndeti. Si ishte?

**Mavraj:** Mua nuk mu duk fare ashtu. Baca Jakup ka një gjykim shumë të kthjellët dhe shumë të qartë, pavarësisht se ai i ka 72 vjet është pensionist dhe e kanë munduar dhe e kanë poshtëruar gjatë bastisjes këtu. Sigurisht e ka përjetuar keq. Unë fare nuk e kisha atë përshtypje. Madje, mua mu duk më i shëndetshëm dhe shumë i relaksuar. Ai është i regjur nëpër burgje. Shikoni, unë me vete e

kam pasur edhe Sadikun (Zeqiri), drejtorin e gazetës, jo për shkak se është i gazetës, por për shkak të arsyeve të tjera. Së pari, ai ka qenë i përfshirë në Lëvizjen Studentore të '97-s, pastaj ka qenë ushtar, më pas i burgosur dhe i mbijetuar i masakrës së Dubravës. Dhe të gjithë iu refereroheshin atij se në çfarë burgu jemi ne dhe ku ke qenë ti. Madje as burgjet jugosllave nuk krahasoheshin me masakrën në burgun e Dubravës, me ato që kanë hequr të burgosurit tanë shqiptarë në Dubravë në krahasim me Hagën dhe me të gjitha ato mundësi që i kanë atje. Aty i vetmi dallim është se ata ngelin aty, njerëzit shkojnë e vijnë, ata ngelin aty, në Hagë. Familjet u shkojnë, pavarësisht "torturave" e heqave shumë të mëdha që i kanë. Kur të shkosh vetë ke për ta parë sa sfidë është...

**Frontal:** Pse?

**Mavraj:** Sepse duhet t'i ndërrosh katër avionë. T'i ndërrosh katër avion dhe të presësh në ato aeroporte gjigante ... është edhe vështirë edhe të orientohesh sidomos kur nuk ke qenë më parë dhe nuk ke qenë shpesh. Pritjet e gjatë, kontrollat në detaje në aeroporte janë të mërziqshme dhe të mundimshme sidomos nëse shkojnë moshat e vjetra, bie fjale për prindërit e tyre, bashkëshortja e bacës Jakup e kështu më radhë. Pastaj orientimi në atë qytet të madh... duhet të jesh i shoqëruar nga dikush i atyshëm se përndryshe të humbin terminet dhe të humb vizita. Sfidë është edhe kthimi mbrapa. Është mundim i madh. Sigurisht edhe në kohën e ish-Jugosllavisë, disa nga këto familje, përfshirë familjen e bacës Jakup kanë pasur sfida të udhëtimeve të largëta dhe me rreziqe. Tash është kohë tjetër, mundësi tjetër, por është shumë sfiduese për familjet. Megjithatë, tri herë në muaj kanë të drejtë të shkojnë për vizitë. Ata thjesht janë sikur këtu vetëm pse mbesin atje.

**Frontal:** E takuat edhe Nasim Haradinajn?

**Mavraj:** E takuam edhe i kishte mbetur hatri pak pse nuk e kemi përshtirë në protokollin e vizitës. Na tha, si miq të vjetër që jemi qysh për 25-vjetor nuk me keni përfshirë mua të parin. I thash herën tjetër vetëm me ty do të kërkojmë takim ...

**Frontal:** Çfarë thoshte Nasimi?

**Mavraj:** I mirë, i mirë, i këndshëm.

**Frontal:** Kam dëgjuar se Nasimi po gatuate edhe për të tjerët në burg?

**Mavraj:** Të gjithë ata shërbenin vetë edhe neve na shërbyen. Me ka ardhur mundim pak, hajt për Hashimin më i ri, por për bacën



Jakup me ka ardhur rëndë të na shërbejë neve, por ne nuk kishim të drejtë të shkonim atje, përpos ai vetë. Ishte një dhomë përpallë si lloj kuzhine për vizita. Ishin disa dhoma.

**Frontal:** A kishin të drejtë të rrinin bashkë gjatë ditës?

**Mavraj:** Po. E kishin sallën dhe kuzhinën e përbashkët. Nëse Nasimi ju përgatit ushqim si ka me ua dërguar në dhoma? Pastaj ata e kanë kohën ku secili kthehet në dhomën e vet ku në dhomën e vet secili i ka kushtet e mira. I kanë të gjitha mundësitë, TV, gazeta, libra dhe çfarë të duan. Kanë lexuar shumë dhe janë shumë më të kthjellët dhe më të relaksuar.

Kështu që ato që kam dëgjuar po ta them shumë thjesht janë komplet të paqëndrueshme. Ata janë top fare.

**Frontal:** Edhe Sadik Zeqiri me tha në telefon se ata janë më mirë sesa e kan menduar para se t'i takonte...

**Mavraj:** Ne kur shkuam aty na vonuan pak në hyrje pas pauzës së drekës, sepse hyri një autoambulancë brenda dhe mendja me shkoi të baca Jakup. Jo morë çfarë, kishte qenë i sëmurë dikush tjetër, ndonjë i burgosur i shteteve të tjera.

**Frontal:** Në qendrën e paraburgimit kishte edhe të burgosur tjerë?

**Mavraj:** Po, aty ka edhe të shteteve të tjera. Kryetarë të shteteve të tjera, të burgosur të tjerë të Gjykatës Penale Ndërkombëtare...

**Frontal:** Nga këta që gjenden në Hagë, kanë pasur edhe dhimbje. Zoti Kadri Veseli ka përjetuar humbjen në familje. Po ashtu edhe Hysni Gucati...

**Mavraj:** Po i pat disa raste, por ai (Kadri Veseli) ka qenë dinjitoz kur i kanë ndodhur rastet në familje, por edhe tani gjatë paraburgimit. Natyrisht është shumë e vështirë të përjetosh vdekjen e prindërve kur nuk je afër aty. Por, në fund të fundit, këta njerëz për nja 1 000 herë e kanë ditur vetën të vvarë, të



vdekur dhe të pushkatuar gjatë luftës. Baca Jakup ka qenë edhe më herët në burgje. Ata janë shumë të fortë dhe shumë të stërvitur. Kushdo që mendon se mund t'i thyejë, demotivojë ose se i bën nervozë ata, e ka gabim, sepse ata vijnë nga një përvojë shumë e ashpër jetësore. Qëndrimi në burg për akuzat luftarëse përveç se i poshtëron për shkak të dosjeve serbe, asnjë lloj përshtypje atyre nuk ua bën.

**Frontal:** E keni bërë një postim në "Facebook" ku keni shkruar pas vizitës atë ditë, besoj se regjia do ta shfaqë: "...për ata që e kanë projektuar harrimin e tyre dhe ngritjet lart mbi fatin dhe kurrizin e këtyre burrave, dy fjale: duke i mbajtur kaq kot e kaq padrejtësisht strategjet e lirisë, ky vend këtu po bëhet e kundërta, vend pelegrinazh ku s'bën pa shkruar se paku një herë".

**Mavraj:** Vend pelegrinazhi.

**Frontal:** Por të ndalemi pak të kjo fjalia e parë, para se të shkojmë të "pelegrinazhi", sepse ke thënë "ata që e kanë projektuar harrimin e këtyre burrave..."...Kush po e projekton harrimin e tyre?

**Mavraj:** Arsim, e ke shfaqur tash këtu në ekran foton me Sadikun. Këtij i ka vdekur sot vëllai,...

**Frontal:** Uou!

**Mavraj:** ... Ka pësuar sulm në zëmër në Gjermani...

**Frontal:** Më tregoi Sadiku që e ka keq vëllaun në Gjermani...

**Mavraj:** I shpreh ngushëllime Sadikut, familjes, fafesisit dhe të gjithë shokëve të tjerë. Një pjesë të gjërave që kam dashur t'i

them veçse i kam harruar duke hyrë këtu. Tash kthemi tek kjo fjalia,... tek cila u ndale më së pari?

**Frontal:** Te fjalia e parë kur thua "ata që e kanë projektuar harrimin e tyre"...

**Mavraj:** Saktë. Shiko, harrimi i tyre është projektuar qysh gjatë luftës. Kanë qenë gjithmonë në thumb të ofendimeve dhe sharjeve, jo vetëm ata, por e tërë UÇK-ja, jo vetëm nga shtypi serb, por edhe nga shtypi shqiptar që i ka shprehur mendimet serbe, në atë kohë. Ju i dini strategjitë e vjetra që kanë ndodhur edhe tek shtetet tjera apo popujt tjerë gjatë epokës së çlirimit, të cilët mezi janë çliruar: Së pari vrasja morale e figurave të larta, pastaj burgosja e tyre në ashtu që që të shihet si fitore ose si festë burgosja e tyre. Konkretisht, kjo gjykatë buron nga raporti i Dick Martyt për të cilin tashmë mbarë bota e ka kuptuar që ka qenë i paguar bukur shumë nga Serbia dhe shërbimet ruse. Ndërkohë, doli që vetë shërbimet serbe kanë planifikuar vrasjen e tij për të na fajësuar neve si shqiptarë. Të thuash "projektimi i harrimit të tyre" është fjala për projektimin e shkatërrimit ose asgjësimin e tyre, bashkë më të edhe njollosjen e luftës çlirimtare, që qëllimin përfundimtar e kanë deshtetëzimin e Kosovës ose krijimin e perceptimit se Kosova është shtet kriminal, i shpallur në mënyrë të paligjshme dhe i paaftë që të vetëmbahet, i paaftë që të jetë i mëvetëshëm, e rrjedhimisht, edhe politika perëndimore si politikë e gabuar e ngritjes së një shteti në territorin serb ku

Serbia shfaqet si viktimë këtu. Të gjitha këto janë në atë funksion dhe në asnjë funksion tjetër. Krahas tij, këtu përshtypja ime ka qenë dhe është, krahas projektit të Dick Martyt që e ka vitin 2010 dhe është viti i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë e cila Kosovës nuk ia mohoi të drejtën e shpalljes së pavarësisë, mëvetësisë, 22 korrik 2010. Në një binarë tjetër paralel është investuar shumë që të ngritën edhe forca politike që janë veç më të egra në kritika kundër Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Këtu mund të kenë bërë gabime edhe shumë kolegë tanë (gazetarë) që i kanë demonizuar këta njerëz, ndoshta pa e kuptuar se qëllimi përfundimtar është kjo që po ndodh tani. Qëllimi përfundimtar ishte kjo që është duke ndodhur tani. Koha do t'i tregojë njerëzit. Koha do t'i sqarojë gjërat, kjo e sotmja dhe koha që vjen. Dhe mendoj se këta dy binarë, i investimit në politikë e në politikanë që e demonizojnë UÇK-në, çoftë me akuzat për luftën apo pasluftën, dhe ky binari tjetër i Gjykatës Speciale që buron nga raportet e Serbisë dhe Dick Martyt, të takohen dikund dhe u takuan në vitin 2019-20. Rrjedhimisht kjo gjykatë speciale del si parti speciale që eliminon një grup të politikanëve dhe i ngrit figura dhe politikanë të tjerë me politika tërësisht demonizuese.

**Frontal:** Por aktualisht...

**Mavraj:** ...Dhe në këto politika tërësisht demonizuese për fatin e keq janë edhe disa ish-shokë të mi. Duke qenë shokë këta, e shokë këta, ish-shokë këta e ish-shokë këta, pozicioni im bëhet

me delikat, por ndërmjet tyre zgjedh pozicionin tim dhe e them atë që e mendoj. Dhe mendoj se kjo po ndodh, njerëzit kur ta kuptojnë, dhe duhet ta kuptojnë se në funksionin të çkafit kanë vepruar deri më tani, duhet t'i ndryshojnë politikën, qasjet, dhe duhet ta kuptojnë shumë mirë se e tëra ka qenë në funksion të shkërmoçjes së attributeve shtetërore të Kosovës, duke përfshirë politikën e jashtme e cila është tërësisht e shkërmoçur dhe duke përfshirë të kaluarën e cila është tërësisht nën akuzat më të zeza që mund t'i ndodhin një kombi.

**Frontal:** Por, një shok i juaji është kryeministër i Republikës së Kosovës...

**Mavraj:** Po edhe ai dhe shumë të tjerë, dhe ata duhet t'i thërrasin arsyes, ta kuptojnë funksionin e tyre, ta dinë mirë qysh kanë fituar dhe pse kanë fituar dhe qysh kanë ardhur. Dhe të përpiqen ta shfrytëzojnë një drejtim tjetër, jo në këtë drejtim ku janë, por në një drejtim më pozitiv. Ta mendojnë Kosovën dhe jo emrat e përveçëm dhe ta kapin këtë rast që e kanë tani ose që është duke u krijuar që gradualisht ta shfaqin kritika institucionale, konstruktive, të arsyeshme, logjike, faktike dhe ta bazuar para çdokujt për devijimin e misionit të Gjykatës Speciale...

**Frontal:** A ka vullnet për ta bërë një gjë të tillë nga ky pushtet?

**Mavraj:** Dikush duhet ta bëjë....

**Frontal:** A janë këta?

**Mavraj:** Jo. Këta nuk janë, por ose duhet të ndryshojnë ose duhet të shkojnë (largohen). Njëra duhet të ndodhë, për

shkak se dëmet mund të jenë më të mëdha sesa ata mund t'i kenë imagjinuar kur kanë bërë ftesa që këta të shkojnë në burg ose akuzat tjera që ata i kanë bërë. Koha po ikën, jemi 23 vjet pas luftës dhe ajo që është më e dhimbshme për mua është se mandati i presidentit Joe Biden po na shkon tërësisht kot dhe pa iniciativë konkrete. Gradualisht po shkojmë aty ku dëshiron Serbia: tek konflikti i ngrirë i Kosovës, diçka ngjashëm si ai Nagorno-Karabakh që ata (serbët) e kanë përmendur disa herë, po ashtu edhe strategjinë e zvarritjes së Kosovës e cila është tërësisht strategji ruse. Sa më shumë që nuk zgjidhet ky problem ata (rusët) aq më shumë janë të pranishëm, dhe duke u thirrur në rastin e Kosovës ose pavarësinë e saj t'i bëjnë sa më shumë berbatë ata fqinjët e vet, në ato rajonet ku u mbajtën referendimet qesharake (Ukrainë) dhe në Gjeorgji në dy krahina, në Ukrainë në pesë rajone, në Krime dhe këto katër tjerat. Pra, ne nuk jemi jashtë një mozaiku ose konteksti ndërkombëtar. Duhet ta kuptojmë se në cilën pjesë të kontekstit ndërkombëtar jemi ne dhe cila situatë është më e favorshme për ne si shtet. Ikja e kohës me Lajçaka dhe me këta, po të kallzoj se është një kohë që nuk kompensohet.

**Frontal:** E kemi parë një vizitë, prej të rrallave të kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca në Hagë. U mendua që do të pasonin vizita të tjera, por më nuk kishte....

**Mavraj:** Nuk ka pasur, por duhet të ketë. Në qoftë se njerëzit duan ta argumentojnë se janë të Kosovës dhe për Kosovën,-



Në studio: Muhamet Mavraj, publicist

**TAKIMI ME ISH-KRERËT E UÇK-SË, ÇFARË PO BËN SHTETI NË MBROJTJE TË TYRE?**





duhet të ketë. Unë nuk do të shkoja ndryshe pos kështu qysh i konceptojë gjerat. Këta njerëz nuk janë të akuzuar si individë, por janë ta akuzuar në nivel institucional dhe nëse do ta them metaforikisht është e akuzuar liria e Kosovës. Të gjitha përpjekjet atje janë që lufta jonë të shpallet kriminale dhe terroriste sepse ashtu flasin dokumentet e dosjet serbe dhe se Serbia është viktimë.

**Frontal:** Çfarë duhet të bëjnë institucionet e Kosovës për t'i mposhtur këto dëshmi të Serbisë?

**Mavraj:** Së pari nuk duhet ta shkatërrojnë Ministrinë e Punëve të Jashtme (MPJ) siç e kanë shkatërruar. Duhet me kthyer aty ku është. Një ditë kam hyrë në uebsajtin e MPJ-së për interes të studentëve, për tema dhe për të verifikuar diçka, aty e kishin zhdukur të gjithë historinë e MPJ-së, përfshirë listën e shteteve që e kanë njohur Kosovën dhe disa tema të rëndësishme, lajme, arkiva të mëhershme. Aty kishte mbetur vetëm një libër i Skender Hysnit për GjND-në dhe një broshurë për UNESCO-s që ka qenë, asgjë tjetër. Historia fillonte më 5 ose 6 qershor të këtij viti. Madje në uebfaqe nuk kishte as materiale në anglisht, vetëm shqip. Nuk e di se si neve do të na kuptojë bota. A duhet ata ta mësojnë shqipen që të na kuptojnë gjë që nuk do ta bëjnë... E pastaj në shtylla tjera.

**Frontal:** Në krye të MPJ-së ne kemi një ministere, e cila më herët ka treguar se ka dorëzuar dosje në Gjykatën Speciale kundër këtyre...

**Mavraj:** Lë t'i mban në ndërgjegjen e vet ajo, jo vetëm ato deklarata, por edhe të gjithë ato tjerat. Unë nuk akuzoj kurrë një ministere të caktuar për asnjë lloj teme, sepse nuk janë autoritete përfundimtare të një qeverie. Por, pasi me pyete se çfarë duhet të bëjnë, unë të

tregova se çfarë nuk duhet të bëjnë dhe të ecim tutje në zbërthimin e së vërtetës për Kosovën, e cila nuk bëhet me këta njerëz të cilët nuk e njohin ose kanë perceptime të ngjashme me kundërshtarët e luftës së UÇK-së, me urrejtje të paparë, patologjike. Ka shkuar madje deri në stratosferë urrejtja kundër këtyre njerëzve të luftës, shumë më përpara, por kanë dashur ta institucionalizojnë këtë urrejtje kështu qysh është duke ndodhur. Nuk është në pyetje individ, por komplet programi nga kryeministri e deri tek ai i fundit.

**Frontal:** A keni besuar që Albin Kurti të jetë aq indiferent ndaj zhvillimeve atje?

**Mavraj:** Po, patjetër kam besuar.

**Frontal:** Pse?

**Mavraj:** Sepse qysh atëherë nuk ka pasur ndonjë simpati për luftën. Ka edhe deklarime kundër, por si koncept pacifist i dikujt e shoh normal. Ai është mishëruar me atë literaturën, ideologjinë...

**Frontal:** Albini nuk e donte luftën kur fillojë ajo, në kohën kur ishte në Lëvizjen Studentore?

**Mavraj:** Ai ka qenë i përgatitur vetëm në koncepte pacifiste, por sigurisht aktive. Në drejtim të luftës jo sepse nuk ka asnjë dëshmi, deklaratë. Ka deklaratë kundër luftës. Po flas për atë kohë sepse kur hapet zyra e Demaçit është diçka tjetër, por ai është rrëfim në vete.

**Frontal:** Nuk dua të hy në këtë rrëfim, por dua të ju pyes për angazhimin e shtetit shqiptar. E kemi parë deklaratën e kryeministrit Edi Rama në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së ku foli për UÇK-në, mirëpo në anën tjetër patëm një sulm të presidentes Osmani në "Zërin e Amerikës" kundër Ramës...

**Mavraj:** Ëhë! I kam parë të dy

deklaratat. E kam përcjellë me kënaqësi të thellë fjalimin e kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së, strukturën e atij fjalimi që ka qenë shumë mjeshtërore dhe për dhjetë minuta e ka përmbledhur krejt botën ku i ka fokusuar interesat dhe pozicionet shqiptare, përfshirë edhe ato në krahë të Ukrainës dhe kundër luftës ruse, dhe këtë për Gjykatën Speciale të Kosovës dhe akuzat banale kundër krerëve të shtetit të Kosovës. Në fakt mbajtja në paraburgim pa aktakuzë për një kohë të gjatë e pastaj vazhdimi i hetimeve pasi është shfaqur një aktakuzë. Ndërsa sulmet kundër këtij fjalimi ose në përgjithësi paraqitjeve publike të kryeministrit të Shqipërisë nga këta liderët e Kosovës i shohë në vazhdim të qëndrimeve të mëparshme, por shumë të papjekura. Edi Rama kishte qëndrim të burrshtetasit të vërtetë, shqiptar, jo vetëm për Shqipërinë, por për të gjithë shqiptarët. Ndërsa, më pas këto deklaratat e sipërcituara vetëm sa e konfirmojnë papjekurinë institucionale...

**Frontal:** Po flasim për qëndrimin e presidentes së Republikës së Kosovës...

**Mavraj:** ...Po, për presidenten e Republikës së Kosovës, papjekuri e thellë dhe qëndrim larg qëndrimit të një burrshtetasije të një shteti. Mendoj se ata duhet ta zgjerojnë pak diapazonin dhe perceptimin e situatave dhe ta bëjnë një analizë më të thellë të kontekstit gjeopolitik të Kosovës dhe të Shqipërisë në rrethanat e reja. Duhet të bëjnë deklarata më të mira, më të matura. Nëse nuk mund të afrohen, të paktën të mos na bëjnë dëm më shumë në raportet Kosovë-Shqipëri sepse dëmet veçse janë bërë tashmë.

**Frontal:** Si mund të jenë këto raporte të mira më

kryeministrit shqiptar përderisa, siç ka thënë Osmani, ai është duke ia mbajtur zhagun Vuçiqit?

**Mavraj:** Ka edhe këtu që ia kanë mbajtur zhagun Vuçiqit duke e amnistuar atë nga krimet dhe duke ia lënë përgjegjësinë vetëm Millosheviqit si lider që nuk i ka pyetur ministrat përfshirë edhe Vuçiqin si ministër të Propagandës. Dhe kjo nuk është bërë nga krerët e Shqipërisë, por është bërë nga krerët tanë, të Kosovës. Duhet pjekuri dhe maturi më e madhe, zgjedhje e fjalëve, një diskurs më pozitiv, dhe atë vitrinën e fjalorit ta pastrojnë sepse ata paraqesin (përfaqësojnë) diçka më shumë sesa vetjet e tyre kur kanë qenë në funksione partiake ose në grupe parlamentare e kështu më radhë. Tani janë krerë të shtetit dhe peshojnë shumë dhe bëjnë dëme shumë të mëdha sikurse mund të bëjnë të mira shumë të mëdha me qëndrime pak më ndryshe dhe jo kësi largimi. Ftohtë me Amerikën, ftohtë me Shqipërinë, ku duam të shkojmë kështu?! Nuk ka shansë të shkojmë askund pa Amerikën dhe Shqipërinë dhe pa raporte të ngrohta me këto dy shtete, sepse tek e fundit Shqipëria është pjesë e trupit tonë.

**Frontal:** Vizita juaj në Hagë ndodhi në 25 vjetorin e protestave të 1 tetorit 1997. Ju qëlloni kjo ditë apo?

**Mavraj:** Jo s'ka qëlluar hiç, por e kam rregulluar shumë mirë dhe me kohë. As më 30 shtator e as më 2 apo 3 tetor, por pikërisht më 1 tetor edhe pse ishte e shtunë, sepse më 1 tetor ishte 25-vjetori dhe jo me ndonjë datë tjetër. Kam menduar që këta tjerët (ish liderët tjerë të '97) që mbesin këtu në Kosovë do ta bëjnë një plan pak më të mirë dhe të shkojnë për vizita tek familjet e studentëve dëshmorë dhe ndonjë aktivitet tjetër që i përngjanë 1 tetorit

1997, por ata po fokusohen vetëm në këtë programin e ngushtë në të cilin unë nuk shkoj dhe nuk do të shkojë as në të ardhmen sepse kemi shumë njerëz që i kemi lënë në harresë. Por, kësaj radhe, nga të gjallët, askush më shumë nuk e ka merituar që të vizitohen sesa krerët e UÇK-së dhe me ta të festoj 25-vjetorin. Kanë shumë respekt 1 tetorin e 1997 ku disa nga ta kanë qenë më të afërt me zhvillimet e asaj kohe. Për këto demonstrata përmendet Adem Demaçi, citohet, se '68-ta buron nga lëvizja paqësore e '64-s, pastaj '81-shi nga demonstratat paqësore të '68-s, ndërsa UÇK-ja nga demonstratat paqësore të '97-s. Njerëzit në përgjithësi janë të fokusuar pak më shumë tek 1 tetori sepse ishte protesta e parë dhe fundi i heshtjes

**Frontal:** Sepse ka pasur edhe protesta tjera...

**Mavraj:** ... po, sepse ka pasur edhe shumë protesta, shumë më të forta, sidomos në 98-ën, kanë qenë shumë të forta, të furishme, dhe ndonjëra goxha e përgjakshme, por, si fillim i rezistencës aktive memoria kolektive po fokusohet aty tek 97-ta. I kuptoj për këtë njerëzit, por meqenëse ata po e respektojnë shumë 1 tetorin dhe ishte pikërisht 25 vjetori i 1 tetorit 1997, shpirti jem në këtë 25 vjetor ishte me ata që janë në Hagë.

**Frontal:** Në fillim e nisim me ata që janë në Hagë, po dua të pyes se a të pyeten për zhvillimet politike në Kosovës?

**Mavraj:** Po. Me kanë pyetur për zhvillimet politike në Kosovë dhe për një perceptim timin, por fare nuk kanë qenë dominant asnjë lloj zhvillimi këtu në Kosovë ose për këto të metat e kësaj qeverie sepse do të ishte humbje kohe, sepse i dinë të gjitha. Lexojnë, shohin, dëgjojnë lajme e kështu me radhë, por ka qenë e pashmangshme si pyetje. Për sa i përket pikëpamjeve të tyre, ata kur kanë shkuar atje janë marrë vesh që politikën ta lënë jashtë. Rexha thoshte politikën dhe dallimet i kemi lënë jashtë tek dera, kur të dalim ndoshta i marrim ndoshta i lëmë aty. Në përgjithësi brenda tyre nuk ka ndonjë lloj magjie marrja me lajme ditore.

**Frontal:** Zotëri Mavraj të falënderoj shumë që ishe në emisionin "Frontal"!

**Mavraj:** Faleminderit! Respekt, Arsim! Faleminderit prej teje dhe prej shikuesve që na përcollën!

**Frontal:** Besoj që ka pasur një interesim të jashtëzakonshëm, po më tregojnë edhe nga regjia, për të dëgjuar këtë rrëfim tuajin. Faleminderit shumë!

**Mavraj:** Më vjen shumë mirë! Respekt!



# Opozita e pakënaqur me zhvillimet ekonomike në vend

EPOKA  
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 10 TETOR - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se rritja ekonomike sipas Bankës Botërore është 3.1 për qind e jo siç e ka projektuar qeveria Kurti 10.5 për qind. "Inflacioni, po ashtu sipas Bankës Botërore, është 19.1 për qind. Kjo i bie se fuqia blerëse e qytetarit të Kosovës është përgjysmuar. S'ka si të jetë ndryshe kur janë shtrenjtuar të gjithë artikujt e domosdoshëm për jetesë e qeveria e ka bllokuar Ligjin e Pagave. E ka bllokuar edhe ndërtimin e kapaciteteve të reja energjetike, siç ishte 'Kosova e Re' dhe gazsjellësi amerikan, me arsyetime qesharake, se megavati prej 80 eurove i dukej i shtrenjtë, e sot çmimi i tij pothuajse është dhjetëfishuar", ka deklaruar Haradinaj.

Ai ka theksuar se prej 706 milionë eurove të planifikuara me buxhetin e shtetit për investime kapitale, janë realizuar vetëm një e dhjeta e tyre. "Në çdo sferë ekonomike e sociale ka rënie drastike. Rritje kanë shënuar vetëm importet e mallrave nga Serbia. Kjo qeveri e ka kapërcyer çdo parashikim dhe importet nga Serbia prej 174 milionë eurosh në vitin 2020,

kanë mbërritur në mbi 306 milionë euro, që është për 76 për qind më shumë nga viti paraprak. Prandaj deklaratat për rritje ekonomike, pa fakte, janë ofendim për një vend e për një popull të tërë!", ka thënë ish-kryeministri Ramush Haradinaj.

Ndërkaq deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Avdullah Hoti, ka thënë se shtatë muaj pasi janë rritur çmimet e materialeve dhe janë bllokuar investimet publike, të hënën në Komisionin për Buxhet diskutuan për projektligjin e sjell nga qeveria lidhur me mbështetjen e punëve publike. "Ky draft i ligjit nuk e zgjidh problemin e investimeve të ulëta kapitale të qeverisë dhe komunave të cilat investime janë në nivele rekord, më të ulëta ndonjëherë. Projektligji është gabim nga fundi në krye, krijon pasiguri dhe e çrregullon konkurrencën. Pavarësisht këtij ligji, ky vit është i humbur pasi është tepër vonë për të pasur ndonjë ndikim në realizimin e investimeve brenda këtij viti. Përqindja e caktuar për kompensim të koston së materialeve për shkak të rritjes së çmimeve është arbitrare. Projektligji ka edhe shumë defekte të tjera, të cilat do t'i bëjë të ditura në seancë", ka

thënë Hoti.

Ish-kryeministri Hoti ka thënë se intervenimi ligjor për të zgjidhur këtë problem duhet të jetë i thjeshtë, përmes plotësimit me disa nene të Ligjit të Prokurimit Publik për t'i përshtatur çmimet e materialeve ndërtimore në kontrata sipas çmimit të tyre në bursë. "Ky intervenim duhet të vlejë vetëm për kontratat ekzistuese, sepse kontratat e reja lidhen me çmime të reja. Çdo qasje tjetër krijon pasiguri dhe kaos në menaxhimin e kontratave publike", është shprehur Hoti.

## Kurti lavdërohet me sukseset në ekonomi

Një ditë më parë kryeministri Albin Kurti ka thënë se ka përparim ekonomik në vend, duke numëruar sukseset e qeverisë në këtë fushë. "Përmes Pakos së Ringjalljes Ekonomike, Masës 2.1, subvencionuam 20 për qind të kryegjësë së kredisë për bizneset prodhuese e përpunuese. Kjo masë kap vlerën prej 15 milionë eurosh mbështetje direkte që u ka mundësuar 207 bizneseve të investojnë mbi 87 milionë euro në zgjerim të kapaciteteve. Me Masën 2.4 ofruam mbështetje për trajnime të stafit, brendim të produkteve e mbështetje për

panaie jashtë vendit për të gjetur tregje të reja. Mbështetje nga e cila përfituan 75 biznese. Pra, u kemi ndihmuar bizneseve tona vendore që të zgjerojnë kapacitetet prodhuese e përpunuese ashtu që të rritet prodhimi vendor, punësimi e eksporti", ka thënë Kurti.

Ai ka shtuar se eksporti përgjatë periudhës janar - shtator 2022 është 25.6 për qind më i lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. "Rritja mesatare vjetore e eksportit gjatë periudhës janar - shtator të viteve 2008-2020 është 15.7 për qind, ndërsa rritja mesatare e eksportit në periudhën e njëjtë të dy viteve të fundit e gjatë qeverisjes sonë është 47.3 për qind. Pra, me qeverinë tonë eksportet në këtë periudhë janë rritur trefish më shpejtë sesa në krahasim me vitet kur kanë udhëhequr qeveritë e kaluara. E rritja e eksportit pa dyshim nënkupton edhe rritje të aktivitetit ekonomik dhe punësimit në vend", ka thënë kryeministri Kurti.

Ai ka theksuar se qarkullimi i bizneseve për periudhën janar - gusht 2022 ka shënuar rritje prej 21.6-përqindësh krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2021 dhe 67.9 për qind krahasuar me vitin 2020. "Si rezultat, në vitin 2021 kishim të regjistruara 25 mijë

vende pune më shumë sesa ai pararendës, kurse nga janari deri në gusht të këtij viti kemi 15 mijë vende pune më shumë. Përveç ndihmës direkte me subvencione, po ndihmojmë bizneset tona përmes uljes së koston së të bërit biznes. Vitin 2021 e mbyllëm me hapjen e terminalit doganor shtetëror në Mitrovicë. Këtë vit, terminalin doganor në Podujevë e kthyem në shtetëror. Njësoj do të vazhdojmë me hapjen e terminalit doganor shtetëror në Vermicë", është shprehur ai. Kryeministri ka thënë se këto ditë filloi edhe zhdoganimi i mallrave në Portin e Durrësit. "Kjo do t'i ulë koston për bizneset e konsumatorët për rreth 2 milionë euro sikurse edhe kohën e zhdoganimit. Investimet e huaja direkte në Kosovë vazhdojnë të rriten gjatë qeverisjes sonë. Në periudhën janar - korrik të këtij viti vlera e investimeve të huaja direkte ka tejkaluar vlerën prej 400 milionë euro. Pra, 47 për qind më shumë në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2021 dhe 99 për qind me shumë sesa në vitin 2020. Progresi ekonomik nuk është hamendësim e as rastësi. Ai është rezultat i politikave të duhura dhe qeverisjes së mirë. Shifrat dhe indikatorët më lart janë dëshmia jonë për këtë", ka deklaruar Kurti.



**EURO GLASS**  
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
 Enverti  
 Adr: Fushë Kosovë  
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
 E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'**  
 TEL: 045/82 82 82

# Milani për hakmarrje ndaj Chelseat



## "Epoka e re"

**MILANO, 10 TETOR** - Grupi E është ndër më interesantët në Ligën e Kampionëve, pasi të gjitha skuadrat janë në garë për kualifikim, kur kanë mbetur edhe tri ndeshje për t'u zhvilluar. Vëmendja kryesore do të jetë në derbin e madh në mes të Chelseat dhe Milanit, skuadra që u përballën edhe javën e kaluar në "Stamford Bridge" dhe fituese doli skuadra angleze me rezultat 3-0. Të dyja këto skuadra kanë nga katër pikë dhe të dyja kërkojnë fitore për të qenë sa më afër kualifikimit. Pavarësisht prej humbjes në ndeshjen e parë, Milani është këndellur dhe ka shënuar fitore shumë të rëndësishme në ndeshjen derbi kundër Juventusit (2-0). Edhe Chelsea ka shënuar fitore në fundjavë ndaj Wolverhamptonit (3-0). Mungesat e Milanit për këtë ndeshje janë të shumta: Mike Maignan, Alessandro Florenzi, Zlatan Ibrahimović, Junior Messias, Simon Kjær, Davide Calabria dhe Alexis Saelemaekers, kurse klubi anglez do të jetë pa N'Golo Kanté dhe Wesley Fofana. Pa asnjë dyshim edhe ndeshja tjetër e këtij grupi në mes të Dinamo Zagrebit dhe Salzburgut do të jetë shumë interesante, sepse të dyja klubet kanë

synim kualifikimin në fazën tjetër. Në Grupin H do të përballen dy skuadrat e para në tabelë, Paris Saint-Germain dhe Benfica, që kanë nga 7 pikë, derisa Juventus kërkon fitore ndaj Maccabi Haifas për t'i shtuar me shumë shpresat për kualifikim. "Zonja e Vjetër" nuk po kalon nëpër formë të mirë, por në këtë ndeshje llogaritet favorite absolute.

## Formacionet e mundshme:

Milan: Tatarusanu; Dest, Kalulu, Hernandez; Bennacer, Tonali; Krunic, Leao; Giroud.  
 Chelsea: Kepa; Chalobah, T Silva, Koulibaly; James, Loftus-Cheek, Chilwell; Sterling, Aubameyang, Mount.

GRUP E				GRUPI G			
21:00 Milan - Chelsea 21:00 Dinamo Zagreb - Salzburg				18:45 Copenhagen - Manchester City 21:00 Borussia Dortmund - Sevilla			
Tabela				Tabela			
1. Salzburg	3	5 pikë		1. Manchester City	3	9 pikë	
2. Chelsea	3	4		2. Borussia Dortmund	3	6	
3. Milan	3	4		3. Sevilla	3	1	
4. Dinamo Z.	3	3		4. Copenhagen	3	1	
GRUPI F				GRUPI H			
21:00 Celtic - Leipzig 21:00 Shakhtar Donetsk - Real Madrid				18:45 Maccabi Haifa - Juventus 21:00 Paris Saint-Germain - Benfica			
Tabela				Tabela			
1. Real Madrid	3	9 pikë		1. Paris Saint-Germain	3	7 pikë	
2. Shakhtar D.	3	4		2. Benfica	3	7	
3. Leipzig	3	3		3. Juventus	3	3	
4. Celtic	3	1		4. Maccabi Haifa	3	0	

## SHKURT

### Nuza ndan drejtësinë në ndeshjen e Ligës së Kampionëve U19

Gjyqtarët e futbollit të Kosovës po vazhdojnë paraqitjet e tyre të njëpasnjëshme në garat evropiane. Së fundmi, UEFA ka vendosur që gjyqtarët Genc Nuza t'ia besojë ndeshjen e Ligës së Kampionëve U19 ndërmjet skuadrës çeke Viktoria Plzen dhe asaj gjermane Bayern Munchen, e cila zhvillohet të mërkurën, në orën 13:00, në kuadër të Grupit C. Në mesjavën e kaluar skuadra çeke e ka befusuar skuadrën gjermane (2-1) në Munchen. Krahas Nuzës, në këtë ndeshje do të jenë edhe dy asistentët, Fatlum Berisha dhe Bujar Selimaj.

### KHF Ferizaj ndalet në Kupën Evropiane

KHF Ferizaj është ndalur në raundin e dytë të Kupës Evropiane (EHF European Cup). Ferizaj pësoi nga skuadra polake Gminy Kobierzyce, këtë herë me rezultat 38:11. Me rezultatin e përgjithshëm 85:32 pas dy ndeshjeve, Kobierzyce avancoi në raundin e tretë të Kupës Evropiane. Të dyja ndeshjet janë luajtur në Kobierzyce të Polonisë. Në Kupën Evropiane garon edhe Istogu, që pas një jave përballlet me Çairin. Të dyja ndeshjet luhen në Istog.

### KV Luboteni sonte përballlet me Maccabi Yeadim

Ekipi i Superligës A të volejbollit në konkurrencën e meshkujve, Luboteni, ka udhëtuar drejt Izraelit, ku do të garojë në kompeticionin prestigjioz të CEV, "Challenge Cup". Ekipi ka zbarkuar në Tel Aviv, ndërsa e ka zhvilluar edhe stërvitjen e parë. Takimin e parë në rrethin kualifikues Luboteni e zhvillon të martën, më 11 tetor, me fillim nga ora 19:00, sipas kohës sonë lokale, kundër ekipit izraelit Maccabi Yeadim. Ndaj të njëjtit kundërshtar e luan edhe ndeshjen e dytë të enjten, më 12 dhjetor, po ashtu me fillim nga ora 19:00.


## Rumania ende nuk e di se a do të luaj ndaj Kosovës

**BUKURESHI, 10 TETOR** - Rumania është në siklet pasi shorti i kualifikimeve të Kampionatit Evropian e vendosi në një grup me Kosovën. Rumunët nuk janë të sigurt nëse do të paraqiten në fushën e blertë me

Kosovën, shtet të cilin nuk e njeh. Ata do të konsultohen me instancat më të larta, respektivisht me qeverinë e këtij shteti lidhur me këtë ndeshje. "Duke e marrë parasysh faktin se Rumania dhe Kosova

përfunduan në të njëjtin grup në shortin e paraparë për Euro 2024, ngjarje kjo e zhvilluar dje, më 9 tetor, dhe duke marrë parasysh situatën gjeopolitike, Federata Rumune e Futbollit do të dialogojë me Qeverinë e

Rumanisë, nga e cila do t'i mësojë kushtet e ndeshjeve në të cilat përfaqësuesja jonë do të takohet me Kosovën në Grupin I", thuhet në përgjigjen e Federatës Rumune të Futbollit për "gsp.ro".





## Antetokounmpo: Pas pensionimit dua të shkoj në një vend që nuk më njih askush

MILWAUKEE, 10 TETOR - Në moshën 28-vjeçare, me një titull kampion në NBA, basketbollisti grek Giannis Antetokounmpo ka ende shumë për t'i dhënë këtij sporti. Gjithsesi, në prag të sezonit të ri, ai flet për të

ardhmen. "Kur të tërhiqem nga ky sport dua të zhdokem. Dua të shkoj në një vend ku nuk më njih askush", ka deklaruar shtatlarti i ekipit të Milwaukee Bucks. "Dua të bëj njësoj si Tim Duncan. A e di njëri se ku djallin

ka shkuar Tim Duncan?", ka thënë Antetokounmpo, që nuk ka ndër mend të qëndrojë gjithnjë në qendër të vëmendjes së këtij sporti siç bëjnë mjaft yje të NBA-së. "Mendoj gjithnjë për Magic Johnson, që janë të njohur

në gjithë botën dhe janë ende edhe sot aktivë. Ata gjithnjë kanë njerëz që i ndjekin nga pas, por unë nuk mund të veproj njësoj si ata. Shpresoj që të më harrojnë të gjithë pasi të tërhiqem nga sporti", ka deklaruar



## Ramadani, 'ylli i javës' në Superligë

GJILAN, 10 TETOR - Federata e Futbollit e Kosovës së bashku me sponsorin e Superligës, "Albi Mall", vazhdojnë të japin çmimin "ylli i javës" pas çdo xhiroje në elitë. Çmimi i më të mirit për javën e 10 i ka takuar futbollistit të SC Gjilani, Arbnor Ramadani. Vlerësimi i më të mirit të javës është bërë nga komisioni i veteranëve të futbollit. Ramadani ishte shpëtimtar i skuadrës gjilanase, pasi në duelin me Ferizajn realizoi golin e barazimit në minutën e dytë të lojës shtesë. Përveç golit, Ramadani u dallua me lojë të mirë gjatë tërë ndeshjes. Çmimin "Ylli i Javës" për Arbnor Ramadani e dha Adelina Çoçaj, menaxhere e marketingut digjital në "Albi Mall". Pasi mori çmimin, Ramadani theksoi se ndihet mirë për vlerësimin dhe se atë e sheh si motivim për të ardhmen. "Ky çmim besoj se do të më shërbejë si një motivim shtesë për ndeshjet në vazhdimësi. SC Gjilani,



përkundër problemeve të cilat janë të njohura për opinionin, po arrin ta mbajë hapin me skuadrat e tjera. Edhe më tej do ta synojmë kreun e tabelës dhe uroj që sa më shpejt problemet e

klubit të gjejnë zgjidhje. Ne kemi skuadër të fortë dhe kualiteti na lejon që të besojmë dhe të punojmë për kreun e tabelës", ka theksuar Arbnor Ramadani për faqen zyrtare të FFK-së.

## Sainz: Isha në duart e Zotit, makina mbeti në mes të pistës pas aksidentit

SUZUKA, 10 TETOR - Në garën kaotike të Japonisë në Formula 1, zhvilluar ditën e diel në pistën e Suzuka, aksidenti i spanjollit të Ferrarit, Carlos Sainz, ishte vërtet i frikshëm. Si për dinamikën ashtu dhe për mënyrën se si makina qëndroi në mes të pistës, duke u rrezikuar të goditej nga makinat e tjera që kalonin pranë me shpejtësi. Në pistë hyri makina e sigurisë dhe u valëvit flamuri i kuq, që ndali garën. Gjithsesi, ato pak sekonda në mes të pistës së lagur në makinën e tij, teksa shihte makinat e tjera t'i kalonin me shpejtësi para syve, vetëm pak centimetra larg, ishin tragjike për Sainz. "Në kushte të tilla këto aksidente ndodhin. E vërteta është që nuk shihja asgjë që kur nisi gara. U mundova të mos qëndroja pas makinës që kisha përpara, pasi kishte shumë ujë që vinte nga ajo, por kjo lëvizje doli për më keq, pasi në pistë gjeta një vend me më shumë ujë dhe makina më rrëshqiti", ka thënë Sainz. "Problemi më i madh erdhi më pas. Përfundova në mesin e



pistës dhe kisha frikë mos më godisnin makinat e tjera dhe atëherë do të ishte një tragjedi. Askush nuk më shihte që kisha ndaluar aty. Praktikisht, aty isha në duart e Zotit, pasi nuk e di nëse

të tjerët të shohin apo jo. Për fat askush nuk u përplas me mua, por i shihja që kalonin me shpejtësi para meje, vetëm pak centimetra larg Ferrarit tim", ka deklaruar Sainz.

### SHKURT

#### Lëndohet Rrahmani

Qendërmbrojtësi i Napolit, Amir Rrahmani, është lënduar gjatë ndeshjes së Serisë A ndërmjet Napolit dhe Cremoneses të cilën skuadra napolitane e fitoi me rezultat 4-1. Ylli i "dardanëve" u largua nga loja në minutën e 82-të duke u zëvendësuar nga Ostogard. Napoli ka njoftuar përmes një komunikate zyrtare se Rrahmani ka lënduar muskulin e këmbës, por nuk ka dhënë detaje të tjera për shkallën e lëndimit apo kohën e nevojshme për rikuperim. Ndryshe, Rrahmani është duke kaluar nëpër një formë të jashtëzakonshme me Napolin, por edhe me Kosovën.

#### Dybala rrezikon paraqitjen në Kupën e Botës

Argjentina me shumë mundësi do të luajë pa Paulo Dybalan në Kupën e Botës e cila do të luhet në Katar. Ai u dëmtua në ndeshjen Roma - Lecce, ku mendohet se shkalla e dëmtimit është e lartë dhe do të sqarohet nga testet mjekësore që do të bëhen këto ditë. Fjalët e Jose Mourinhos treguan pak shpresë, për të mos thënë aspak. "Si është Dybala? Po them keq, për të mos thënë shumë keq. A do të mungojë gjatë? Unë nuk jam doktor, nuk kam folur me mjekët, por kur dëgjova Dybalan duke folur, e kuptova që ai është shumë keq", është shprehur Mourinho.

#### Musiala infektohet me Covid-19

Ylli i Bayern Munchenit, Jamal Musiala, ka rezultuar pozitiv me Covid-19 dhe është karantinuar. Është ky një tjetër rast me koronavirus te klubi gjerman, pasi më herët kishin rezultuar edhe Joshua Kimmich, Thomas Muller, Manuel Neuer dhe Leon Goretzka. Bayerni ka njoftuar se Musiala ndodhet në gjendje të mirë shëndetësore dhe menjëherë është izoluar sapo ka marrë vesh lajmin e infektimit me Covid.

#### Barcelona dhe Atletico arrijnë marrëveshje për Griezmannin

Antoine Griezmann edhe zyrtarisht është lojtar i përhershëm i Atletico Madridit. Atletico dhe Barcelona kanë arritur marrëveshje për sulmuesin francez, pasi këtë periudhë francezi ishte në huazim nga Barcelona te "rojiblancos". Së fundmi është Atletico që ka njoftuar për arritjen e marrëveshjes me Griezmann që do të jetë në "Metropolitano" deri në vitin 2026. Barcelona ka arkëtuar 20 milionë euro, plus 4 shtesë për ta lënë të lirë lojtarin. Pas zyrtarizimit ka reaguar edhe vetë lojtari, duke u shprehur i lumtur në Madrid. "I lumtur që jam aty ku dua të jem", ka thënë Griezmann.

## Kloppi e pranon: Liverpoolsi është jashtë garës për titull

Trajneri i Liverpoolit, Jurgen Klopp, ka pranuar, pas disfatës ndaj Arsenalit (3-2), se skuadra e tij praktikisht ka dalë nga gara për titullin e kampionit anglez. Pas

nëntë xhirosh, të kuqtë janë në vendin e 10-të me po aq pikë, ndonëse kanë një ndeshje më pak se liderët - Arsenali dhe Manchester City, por edhe 13-14 pikë

prapa ekipeve të lartpërmendura. "Jemi jashtë garës për titull. Sigurisht. Nuk është interesante. Vetëm nëse ndodh ndonjë mrekulli në

muajt e ardhshëm, dhe të gjithë fillojnë të humbasin dhe ne fillojmë të fitojmë. Kjo është gjëja e parë. Mund të flasim për këtë, por në të vërtetë nuk është problemi

ynë. Duhet të gjejmë një mënyrë për të pasur një vazhdimësi lojërash të mira, e kjo nuk ka ndodhur ende", ka thënë Klopp për "beIN Sports".



Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Rec Kos" Sh.p.k. Fushë Kosovë, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

#### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për imiantin për sterilizimin dhe asgjësimin e mbeturinave medicinale sipas kodeve 18 01 01, 18 01 02, 18 01 03\*, 18 01 04, 18 01 06\*, 18 01 07, 18 01 08\*, 18 01 09, 18 01 10\*, 18 02 01, 18 02 02\*, 18 02 03, 18 02 05\*, 18 02 06, 18 02 07\*, 18 02 08, në Sankoc, Drenas.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 02.11.2021 në ora 11:00, në Restaurant Ana Princess, në Autostradën Komoran-Prishtine, Drenas do të organizohet debat publik nga Kompania "Rec Kos" Sh.p.k. Fushë Kosovë në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për imiantin për sterilizimin dhe asgjësimin e mbeturinave medicinale sipas kodeve 18 01 01, 18 01 02, 18 01 03\*, 18 01 04, 18 01 06\*, 18 01 07, 18 01 08\*, 18 01 09, 18 01 10\*, 18 02 01, 18 02 02\*, 18 02 03, 18 02 05\*, 18 02 06, 18 02 07\*, 18 02 08, në Sankoc, Drenas. Debatin Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

Join Zoom Meeting:

<https://us04web.zoom.us/j/3551128793?pwd=b252S1MvQmphd1o3bW8vckxadVorQT09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë "Rec Kos" Sh.p.k. Fushë Kosovë për imiantin për sterilizimin dhe asgjësimin e mbeturinave medicinale sipas kodeve 18 01 01, 18 01 02, 18 01 03\*, 18 01 04, 18 01 06\*, 18 01 07, 18 01 08\*, 18 01 09, 18 01 10\*, 18 02 01, 18 02 02\*, 18 02 03, 18 02 05\*, 18 02 06, 18 02 07\*, 18 02 08, në Sankoc, Drenas.

[https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet\\_dhe\\_publicimet/279/publicimet](https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS

## TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Adnan Halimi shpall të pavlefshme 4 dëftesat shmlt "11 Marsi" Prizren.

- Ernes Avdaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu "Mic Sokoli" Lubeqev.

- Aulon Krasniqi shpall të pavlefshme dëftesat shmlt "11 Marsi" Prizren.

- Ylli Bojaxhiu shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu "Mati Logoreci" Prizren.

- Rinesa Hasani shpall të pavlefshme ID-Kartelën, e Kolegjit AAB, Prishtinë.

- Bahrije Rexhep Ramushi shpall të pavlefshme Licencën e punës të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë së Republikës së Kosovës, me nr. KO-19902.05.22 datë e lëshuar 18.12.2014-18.12.2019

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.







## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

